



VETERANI

GAZETË PERIODIKE. NR. 10(412)

TOTOR 2022

ÇMIMI: 30 LEKË



Drejtor: MUHARREM GJOKA; Kryeredaktor: HALIL RAMA; Zv/Kryeredaktor: SAKIP CAMI & BASHKIM HISARI; website: www.VETERANIOBVL.ORG

100 VJETORI I LINDJES



**SAMI VINÇANI,
KONTRIBUT
REAL NË LANÇ
E USHTRINË
SHQIPTARE**

FAQE 2

SKICË LETRARE



**GJIROKASTRITJA
E PAMPOSHTUR
MESARET
KARAGJOZI**

Nga Dhimitër SHTËMBARI

FAQE 11

DOSSIER



**RAMADAN
GJOKA,
BASHKLUFTËTAR
I MYSLIM
PEZËS DHE
TUK JAKOVËS**

Nga Halil RAMA FAQE 6

Konferenca e 8-të, SHPENDI TOPOLLAJ zgjidhet kryetar i Degës së OBVL Durrës

OBVL, MBROJTËSE E VLERAVE TË LIRISË

**“KORNIZA E RE” E
DIALOGUT MES
KOSOVËS DHE SERBISË**

Nga Bashkim Hisari

Portali në gjuhën shqipe “Albanian Post” publikoi një kornizë të re për marrëveshje në mes të Kosovës e Serbisë, që thuhet se është përpiluar pas angazhimit të këshilltarëve të presidentit të Frances Emanuel Makron dhe kancelarit gjerman Olaf Shulc, pasi siç theksohet në dokument: “Kosova e Serbia në vete nuk do të mund ta zgjidhin kurrë problemin”.

Sipas portalit, thelbi i kornizës është se marrëveshja e re duhet të arrihet deri në mesin e vitit 2023. Me të nuk do të nënkuptohet njohje formale e Kosovës si shtet nga Serbia, por përkohësisht do të mjaftonte që Serbia ta “pranonte” ekzistencën e Kosovës si realitet më vete juridiko-politik.

Sipas planit të paraqitur në kornizën e re, të cilën e ka siguruar portali, në vitin 2023 duhet të nënshkruhet marrëveshja e dytë për normalizim të marrëdhënieve, pas asaj të vitit 2013, me të cilën Serbia faktikisht e pranon realitetin e Kosovës shtet të pavarur, por nuk e njeh formalisht. Në një fazë të mëvonshme, hipotetikusht pas 10 vitesh, atëherë kur BE-ja është e gatshme të zgjerohet dhe ta përfshijë Ballkanin perëndimor, arrihet marrëveshja për njohje të ndërsjellë, si parakusht për dy shtete për anëtarësim në BE. Dokumenti prej katër faqesh, që është i ndarë në tri segmente bashkë me tre nën-titujt që përmbajnë 13 pika, shpjegon logjikën dhe vizionin 10 vjeçar të zgjidhjes së problemit dhe jep një “makro-perspektivë”. Aty precizohet se Serbia nuk do të anëtarësohet në BE pa një normalizim të plotë politik, juridik dhe diplomatik të marrëdhënieve me Kosovën.

FAQE 12



• Mbrojtja, propagandimi, ruajtja, mbajtja gjallë e vlerave të historisë sonë kombëtare, e veçanërisht atyre të LANÇ-it, dhe transmetimi i tyre te brezat pasardhës është dhe mbetet qëllimi themelor i Federatës Shqiptare të Veteranëve

FAQE 3

PROMOVIMI



**VEPRA HEROIKE E HAKI
TAHËS – THIRRJE PËR
BASHKIM KOMBËTAR**

Heroi Haki Taha vrau atë ditë marsi të vitit 1945, emisarin jugosllav, antishqiptarin Miladin Popović

SHPENDI TOPOLLAJ

FAQE 10

IN MEMORIAM

**SEZAI SURROI,
SIMBOL I VLERAVE
PATRIOTIKE DHE
LIRIDASHËSE**

Nga Bashkim Hisari FAQE 7

HISTORIA

**BRIGADA QË GODITI
ME TOP ASAMBLËNË
KUISLINGE**

FAQE 4

78-VJETORI

**HISTORIKU I
BRIGADAVE TË 9 DHE
24 SULMUESE**

FAQE 4-5

PROFILI

**VALIXHJA E
VETERANIT ZENO BOCI**

**Prof. Asoc. Dr.
Bernard Zotaj FAQE 9**

IN MEMORIAM

**SHTATË LAJTHIZAKËT –
DËSHMORËT QË RANË
PËR TRUALLIN ARBËROR**

**Prof. Asoc. Dr.
Zaho GOLEMI FAQE 8**

100 VJETORI I LINDJES

Kryesia e OBVL i propozon Presidentit Begaj ta dekorojë me “Dekorata e Artë e Shqiponjës”

SAMI VINÇANI, KONTRIBUT REAL NË LANÇ E USHTRINË SHQIPTARE



Halil RAMA

Kryesia e Organizatës së Bashkuar të Veteranëve të LANÇ (OBVL), mbështetur në Ligjin nr. 112/2013 “PËR DEKORATAT, TITUJT E NDERIT, MEDALJET DHE TITUJT VENDORË TË NDERIT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, i ka propozuar Presidentit të Republikës, SHT Z.Bajram Begaj, që të dekorojë me “Dekorata e Artë e Shqiponjës”, Z.Sami Kareman Vinçani, me rastin e 100-vjetorit të lindjes, me motivacionin:

“Për veprimtarinë e shquar si luftëtar i lirisë në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare, si dhe për kontributin e tij të veçantë në krijimin dhe konsolidimin e strukturave ushtarake shqiptare. Në vlerësim të mbrojtjes dhe mbajtjes gjallë të idealit atdhetar në drejtim të Organizatës së Bashkuar të Veteranëve të LANÇ-it”.

SAMI VINÇANI - ka lindur 100 vjet me parë, më 10 tetor 1922 në fshatin Vinçan-Korçë. Ai ishte i katërti ndër pesë djemtë e Kareman Sali Dervishit. Familja e Karemanit dhe vëllezërve të tij ka qenë një familje e dëgjuar dhe me kontribute patriotike në Qarkun e Korçës. Në konakun e miqve të familjes, ku ishin varur pushkët dhe portreti i Skënderbeut, vite me rradhë bëheshin biseda me karakter shoqëror e patriotik. Gjyshi i vëllazërisë Vinçani, Sali Dervishi, rreth vitit 1860 kishte kryer në Manastir shkollën fetare, ku veç mësimëve teologjike mori dhe njohuri të shkencave bashkëkohore. Në ato kohë ai ishte ndikuar nga idetë iluministe që kishin filluar të depërtonin në Perandorinë Osmane e ishin ndier deri në ato zona, si në Voskopojë e Korçë. Mbas dezertimit nga ushtria, ai mbështeti, bashkëpunoi e mori pjesë në çetat e Ismail Dërdushës, Kajo Babjenjit e Shahin Matrakut. Djemtë e tij u edukuan e u influencuan nga i ati dhe vazhduan rrugën e tij duke marrë pjesë aktive në Lëvizjen Kombëtare. Njëri nga këta, Kareman Dervishi (babai i Samiut), i njohur si Kareman Vinçani, spikati në mënyrë të veçantë dhe e ngriti më lart veprimtarinë patriotike të familjes. Në fillimet e shekullit XX, ai bashkë me vëllezërit dhe kushërinjtë e tij, bashkëpunoi ngushtë për çështjen kombëtare me figura për-



Sami Vinçani

parimtare e patriote të kohës si: Çerçiz e Bajo Topulli, Mihal Grameno, Sali Butka, Themistokli Gërmenji, Fan Noli etj, duke qënë vetë vazhdimisht Kapedan në krye të një “trume vullnetare”... Në shtëpinë e tyre, në netët e gjata të dimrit në dhomën e burrave ku mblidheshin edhe mjaft bashkëfshatarë, tregohej e këndohej për vepra e ngjarje historike e patriotike, të vjetra e të reja. Recitoheshin vargje të rilindasve e bëheshin biseda me karakter shoqëror, edukativ dhe patriotik.

Në këto ambiente u rritën dhe u edukuan djemtë dhe nipërit e kësaj familjeje të madhe... Samiu pasi kreu filloren në shkollën e fshatit me mësuës xhaxhain e tij Feimin, vazhdoi mësimet në qytetin e Korçës duke udhëtuar çdo ditë më këmbë (Vinçani është 8 km nga Korça). Në vazhdim, iu përkushtua punëve të familjes në bujqësi. Gjatë gjithë kohës nuk rreshiti së lexuari çdo libër apo revistë që i binte në dorë. Ëndrrat rinore për krijimin e një sive moderne në bujqësi e blegtori, i mbetën përgjysëm. Pushtimi i vendit solli në plan të parë të tjera përparësi. Ky brez i fisit, i brumosur me vlerat kombëtare, patriotike e shoqërore të trashëguara nga të parët e tyre, nuk mundej ndryshe veçse, jo vetëm të ishte pjesë e zhvillimeve, por

dhe të merrte përsipër përgjegjësitë e të kryente ndaj atdheut detyrën që i takonte...

Samiu së bashku me gjithë familjen kontribuoi duke u përfshirë energjikisht në Lëvizjen Nacionalçlirimtare qysh në fillimet e saj. Ai u bë krahu i djathtë i vëllait të tij Gjeneralit “Nderi i Kombit” Nexhip Vinçani, udhëheqësit ushtarak kryesor, për ato kohë, të UNÇI të Qarkut të Korçës. Samiun e gjejmë qysh fillimet e vitit 1942 si zv. sekretar e më pas si sekretar të celules së 12 fshatrave të Rrëzës, celula e parë e Qarkut të Korçës. Më vonë përgjegjës për njësitet e armatosura të Rrëzës. Në vazhdim, i ngarkuar me detyra të ndryshme në formacionet luftarake deri komisar batalioni në Br. XV-të.

Mbas luftës shërbeu në detyra të ndryshme në ushtri deri në drejtues brigade me gradën kolonel, si në Gjyrokastër, Korçë, Durrës, Elbasan, Berat, Tiranë dhe prap Elbasan deri sa doli në pension në vitin 1982.

Nuk e rreshiti asnjëherë pasionin për arsimimin. Mbas shkollës së mesme pa shkëputje nga puna, Samiu vazhdoi studimet pa u shkëputur nga detyra, duke kryer me rezultate të shkëlqyera fakultetin historik-filologjik Tiranë 1958-1963 e më pas, 1970-1971 kursin e lartë të Akademisë

Ushtarake.

Që në fillimet e tranzicionit ai mbështeti publikisht, pa rezerva dhe në mënyrë aktive proceset e ndryshimeve demokratike. E spikatur dhe shumë domethënëse është letra e tij, e guximshme për kohën, drejtur R. Alisë dhe KQPPSH në mars 1991, ku shprehej haptazi për zhgënjimin e anëtarëve të thjeshtë të partisë dhe të popullit nga politikat e kaluara të P.Punës sidomos me qëndrimin e gabuar të saj në procesin e ndryshimeve, duke deklaruar në fund se për të gjitha këto: “me keqardhje, po i le rradhët e partisë”.

Nga viti 1991 e deri 1997 ka kryer detyrën e kryetarit të Organizatës së Ushtarakëve në Pension (OUPL) Elbasan.

Samiu luajti një rol të rëndësishëm si pjesë e grupit nismëtar për formimin dhe organizimin e OBVL. Është zgjedhur antar i kryesisë së përgjithëshme të OBVL dhe Kryetar i Degës Elbasan. Qytetarët e Elbasanit edhe sot kujtojnë kontributin e tij me thirrjet drejtuar popullit për ruajtjen e rendit dhe gjakftohtësisë në situatat e trazuara të vitit '97...

Samiu, veçanërisht, iu përkushtua shkruarjes me vërtetësi të historisë së Luftës N.Çl. Autor i disa shkrimeve dhe kumtesave për problemet politike të kohës, sidomos në lidhje me pavarësinë e Kosovës.

Është autori kryesor i Historikut të Fshatit të lindjes dhe autor i Historisë së L.A.N.Ç të Rrëzës së Korçës... Samiu me bashkëautor z.Albert Kotini me realizimin e librit “Vinçanët” në dy volume, la trashëgim për brezat, testamentin e tij atdhetar-intelektual duke kurorëzuar kështu veprën e tij patriotike për të cilën punoi për një kohë shumë të gjatë. Në këtë libër duke vendosur historinë e familjes në kontekstin e zhvillimeve politike shoqërore që nga fillimi i shekullit XX, na jepet një tablo me material shumë të vyer, veçanërisht të periudhës 1942-1944 në qarkun e Korçës. Materiale, dokumenta e dëshmi me vlera të mëdha, sidomos kujtimet e vëllait të tij Nexhipit, si një nga protagonistët kryesorë të LNÇI të qarkut Korçë, mund të përdoren nga studiues të interesuar për shkrimin me vërtetësi historike të Luftës NÇI në qarkun e Korçës. Deri në ditët e fundit të jetës, edhe pse i sëmurë, nuk e rreshiti asnjëherë punën dhe pasionin e tij për historinë, duke pasur në krah e në ndihmë bashkëshorten e tij të vyer, Nedon. Vitet e fundit, i rrethuar dhe nën kujdesin e fëmijëve dhe mbesave, i kaloi në Capua-Itali ku dhe mbylli sytë në 25 dhjetor 2007, duke lënë kujtim veprën e tij dhe duke marrë respektin dhe vlerësimin e familjes, farefisit dhe të gjithë atyre që e kanë njohur.

Vlerësimi i kontributit të kolonel Sami Vinçanit (pas vdekjes), duke i dhënë “Dekorata e Artë e Shqiponjës”, do të ishte vlerësim për Organizatën tonë të Bashkuar të Veteranëve të LANÇ, e cila prej 28 vitesh që nga krijimi i është përkushtuar edukimit atdhetar të shoqërisë dhe të brezave.

SPECIALE

Konferenca e 8-të, SHPENDI TOPOLLAJ zgjidhet kryetar i Degës së OBVL Durrës

OBVL, MBROJTËSE E VLERAVE TË LIRISË

- *Mbrojtja, propagandimi, ruajtja, mbajtja gjallë e vlerave të historisë sonë kombëtare, e veçanërisht atyre të LANÇ-it, dhe transmetimi i tyre te brezat pasardhës është dhe mbetet qëllimi themelor i Federatës Shqiptare të Veteranëve*

Konferenca e 8-të e Degës së OBVL Durrës, që u mbajt më datë 23 shtator 2022, vlerësoi kontributin e veteranëve dhe pasardhësve të veteranëve, anëtarë të kësaj organizate, në evidentimin, ruajtjen dhe promovimin e vlerave të lirisë dhe veçanërisht të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare.

Kryetari i Degës Z.Genci Ballanca që e ka drejtuar atë për 17 vjet, bëri analizë të hollësishme të veprimtarisë së kësaj dege. Ai theksoi veçanërisht përkushtimin e anëtarëve të kryesisë së degës për përmbushjen e misionit historik të OBVL: ruajtjen e traditës luftarake të popullit tonë dhe edukimin patriotik të brezave.

Kontributi dhe përkushtimi maksimal i Z.Ballanca në përmbushjen e këtij misioni historik u vlerësua nda diskutantët në këtë konferencë, si: Z.Shpendi Topollaj, Kujtim Vokshi, Sofika Spiroruti, Fatime Alla, Hënor Libohova etj.

Në emër të Kryesisë së OBVL, Konferencën e përshëndeti Sekretari i Përgjithshëm i kësaj Organizate, akademik Halil Rama – Mjeshtër i Madh. Ndër të tjera ai theksoi se që me krijimin e OBVL para 28 vitesh në korrik 1994, Dega e Durrësit e kësaj organizate u bë promotore e mirëorganizimit dhe mirëfunksionimit të saj.

Me këtë rast, numri dy i OBVL kujtoj me nderim të veçantë kryetarin e parë të degës së OBVL Durrës, Z. z.Idriz Hoxha, kryetarin e nëndegës së Shijakut Z.Osman Xhindoli si dhe u shprehu mirënjohjen të gjithë atyre që kontribuan për gjatë gjithë ekzistencës së Dëgës në këto 28 vite.

Gjithashtu, në emër të Kryesisë së OBVL Z.Halil Rama i shprehu vlerësimin maksimal kryetarit aktual të degës, Z.Genci Ballanca, i cili, me gjithë vështirësitë e panumërta ja doli ta riorganizojë dhe vitalizojë këtë degë, duke zhvilluar aktivitete të panumërta në përkujtim të ngjarjeve e figurave të shquara të LANÇ nga qarku i Durrësit, por edhe duke bashkëpunuar ngushtë me autoritetet e pushtetit vendor për t'i përjetësuar ato me emra rrugësh, si në rastin e ceremonisë mbresëlënëse të vendosjes së rrugës "Nako Spiro", -tha Sekretari i Përgjithshëm i OBVL-së.Në emër të kryesisë së OBVL, ai shprehu vlerësimin dhe mirënjohjen për kontributin e anëtarit të kësaj kryesie, shkrimtarit, publicistit dhe veprimtarit shembullor, Shpendi Topollaj, i cili me librat dhe artikujt e tij mjaftë produktivë e cilësorë, është bërë një nga penat më të njohura e të preferuara për lexuesin. Po ashtu, Shpendi është shquar dhe shquhet për aktivitetin e tij publik me kumtesa e fjalë impresionuese në dhjetra konferenca, simpoziume e takime, dhe veçanërisht me mbështetjen që i ka dhënë degës tuaj të OBVL-së.



Në këtë konferencë u vlerësua edhe krijimi i Federatës Shqiptare të Veteranëve të Luftërave të Popullit Shqiptar për Liri e Pavarësi nga dy organizatat tona të veteranëve, OBVL dhe Organizata e Veteranëve të Kosovës, si dhe aktiviteti intensiv i kësaj Feredate.

Në këtë kuadër, -theksoi Z.Halil Rama, kryesia e OBVL mirëpret kontributin e Degës së Durrësit në mbrojtje të vlerave të lirisë. Pikërisht, në funksion të këtij qëllimi madhor, mbrojtja, propagandimi, ruajtja, mbajtja gjallë e vlerave të historisë sonë kombëtare, e veçanërisht atyre të LANÇ-it, dhe transmetimi i tyre te brezat pasardhës është dhe mbetet qëllimi themelor i Federatës Shqiptare të Veteranëve.

"Në sot jemi krenarë që Shqipëria gjatë Luftës së Dytë Botërore u vendos në anën e antifashistëve, fitimtarëve, dhe frontit të madh të lirisë, kjo është meritë e partizanëve shqiptarë, këtyre kalorësve të çlirimit dhe të lirisë.

Ne krenohemi që në drejtimin e kësaj lufte, nga Njësitët Guerrile deri në drejtimin e Divizionit të 5-të partizan e të Ushtrisë Shqiptare, patëm Heroin e Popullit dhe Nderin e Kombit, gjeneral Rrahman Parllakun, që e drejtoi organizatën tonë me përkushtim të rrallë për 20 vjet..., ashtu siç krenohemi me kryetarin e parë të OBVL-së dr.Ymer Dishnicën – Nderi i Kombit", -theksoi Sekretari i Përgjithshëm i OBVL-së.

Vlerësimi nga Presidenti i Republikës i tre personaliteteve themeluese të organizatës tonë: Dr.Ymer Dishnica, gjeneral Rrahman Parllaku dhe gjeneral Nexhip Vinçani, me titullin e lartë "NDERI I KOMBIT", si dhe dekorimi me "Dekoratën e Artë të Shqiponjës" i personaliteteve të tilla, themeleues dhe bashkëdrejtues të OBVL, si Edip Ohri, Liri Belishova, Myfit Guxholli dhe Xhe-

vdet Ballanca, ia ka rritur prestigjin dhe krenarinë organizatës tonë.

Le të ecim nën shembullin e tyre për ta bërë organizatën tonë promotore të të gjitha zhvillimeve.

Konferenca e 8-të e Degës së OBVL Durrës zgjodhi gjithashtu organet e saj drejtuese për dy vitet në vazhdim.

Kryetar u zgjodh shkrimtari dhe publicisti i mirënjohur Shpendi Topollaj; nënkryetarë u zgjodhën Z.Kadri Tarelli, gjithashtu një nga shkrimtarët e shquar durrsakë dhe Znj.Sofika Xhixhabeci (Spiroruti). Sekretar i Degës së OBVL Durrës u zgjodh Z.Kujtim Vokshi.

SHPENDI TOPOLLAJ, KRYETARI I RI I DEGËS SË OBVL DURRËS

Shpendi Hulësi Topollaj, i cili në Konferencën e 8-të të Degës së OBVL Durrës u zgjodh kryetar i kësaj dege, ka një kontribut të shquar si shkrimtar e publicist i cili në veprimtarinë e tij të gjerë ka pasqyruar më së miri historinë, kulturën, traditat e cilësitë identifikuese të shumë viseve shqiptare si dhe vlerat e shumë figurave të shquara të kombit shqiptar.

Ai lindi në ditën e të dashuruarve, 14 shkurtin e vitit 1947, për t'i dhuruar publikut bujarisht në 70 librat e tij (me prozë, poezi, drama, publicistikë, esse e kritikë letrare) dashuri të pamatë njerëzore.

Shpendi Topollaj njihet si shkrimtari, poeti, publicisti, dramaturgu dhe kritiku letrar, krijimtaria shumëplanëshe e të cilit ka qenë e pranishme sidomos në faqet e gazetave "Telegraf", "Fjala", "Nacional" e "Veterani". Jeta e këtij oficeri dhe juristi, tashmë në pension, autor i rreth 70 librave të të gjitha gjinive brenda harkut kohor prej vetëm njëzetepesë vitesh, njihet gjerësisht brenda dhe jashtë vendit.

Dallgët e jetës i krijuan mundësinë që të shkruaj dhe të botojë vetëm pas

ardhjes së demokracisë. Në të gjithë veprën e tij spikat si talenti dhe erudicioni i thellë, ashtu edhe guximi qytetar për demakimin e të keqes dhe domosdoshmërinë e bashkimit mes shqiptarëve. Kudo ai shfaqet si një intelektual i përgjegjshëm, predikues i vlerave tona kombëtare, i dashurisë për Atdhe dhe marrjen e fateve të tij në duart e vetë shqiptarëve.

Aktiv edhe në jetën e përditëshme, ai drejton me sukses disa shoqata (nënkryetar i Shoq. Komb. "Skënderbegasi" – "Nderi i Kombit" dhe kryetar i degës Durrës etj.), dhe organizon veprimtaritë të shumta kushtuar figurave të shquara apo ngjarjeve të rëndësishme historike, si dhe promovimit të autorëve të ndryshëm, ç'ka duket qartë te 30 librat e tij vetëm me kritika. Për të dhe librat e dala nga pena e tij kanë shkruar me simpatinë më të madhe shumica e personaliteteve tona të artit dhe kulturës të cilat janë përmbledhur në pesë libra voluminozë. Për kontributet e tij, atij i janë akorduar disa tituj si "Ambasador për Paqen", "Naim Frashëri i artë" nga Presidenti i Repub-

HISTORIA

Populli ynë gjatë gjithë historisë së tij, ka përkujtuar dhe festuar me madhësi ngjarjet historike, që tregojnë heroizmin dhe vitalitetin e kombit tonë. I tillë është edhe përkujtimi dhe kremtimi i përvjetorit të 66-të të Brigadës së III-të Sulmuese. E krijuar më 9 Tetor të vitit 1943, në fshatin Arbanë të zonës luftarake të Pezës, kjo njësi relativisht e madhe për kohën kishte në përbërje të saj partizanë të çetës së Pezës, të batalioneve "Dajti" e "Ishmi", intelektualë, të rinj, që erdhën nga qyteti i Tiranës, të gjithë me përvojë dhe të kalitur në betejat e ashpra luftarake me okupatorin, i cili synim kryesor kishte likuidimin e forcave partizane në krahinën e Pezës dhe në zonat rrethore të Tiranës.

Udhëheqja e brigadës bëri organizimin e shpejtë të forcave dhe mjeteve luftarake, caktoi detyrat e njëjve më të vogla, sqaroi situatën politike dhe luftarake, dhe menjëherë ra në ndeshje balllore me armikun në zonën e Pezës dhe në pikat më strategjike në periferi të Tiranës. Rruga luftarake e saj është e gjatë dhe aksionet e saj janë me të vërtetë herokike.

Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Nacionalçlirimtare i ngarkoi detyra të rëndësishme dhe shumë të vështira. Rugën e saj, brigada e vazhdoi në zonën e Dajtit.

Forcat pushtuese, të alarmuara për aksionet dhe dëmtimet e mëdha që pësonin nga partizanët e Brigadës së III-të Sulmuese, organizuan dhe i bënë prita e rezistencë të madhe, sidomos gjatë kalimit për në Çermenikë e në të gjithë zonën e Elbasanit, ku i shkaktoi armikut humbje në njerëz dhe paisje lufte.

Në kushtet e një dimri shumë të egër, me kufizime shumë të mëdha në veshëmbathje, armatime e ushqime (që të gjitha këto i rrëmbeheshin armikut, por edhe nga populli ndihmohej e furnizohej) mundi t'i plotësojë me sukses detyrat shumë të vështira kundër një armiku shumë të madh në forca e mjete luftarake.

Një nga aksionet e suksesshme ka qenë mbajtja nën goditje dhe ndërprerja e herë pas herëshme e rrugës Elbasan-Tiranë, gjë që pengonte dhe bënte të dështonin veprimet e goditjet e armikut, që e kishte të domosdoshme lëvizjen në Jug e në veri të vendit. Vetë komandanti i batalionit gjerman, kapiteni Llokman, në kujtimet e tij thekson: "Luftimet e Arbanës kanë qenë më të ashprat që kam kaluar në Ballkan, që janë zhvilluar deri në përlëshje balllore. U futëm në një kazan values nga i cili nuk dilnim dot, por falë përdimit të diellit, errësira na shpëtoi nga asgjësimi", se "nuk po luftonim me partizanë, por me një ushtri të përgaditur mirë".

Më 17 tetor, njësi të Brigadës goditën me top nga kodrat e Saukut Asamblenë Kuislinge dhe zhvilluan aksione të tjera edhe në qytetin e Tiranës. Marshimi

Me rastin e 79-vjetorit të krijimit të Brigadës së III-të Sulmuese

Brigada që goditi me top Asamblenë Kuislinge



NGJARJE TË RËNDËSISHME HISTORIKE PËR MUAJIN TETOR

- **4 tetor 1944** - U formua në Bicaj të Lumës Brigada e XXIV-të S. e UNÇISH
- **4 tetor 1937** - Ka rënë në Spanjë Heroi i Popullit Asim Vokshi, komandanti i batalionit të III i Brigadës Internacionale "Garibaldi"
- **7 tetor 1942** - Ra heroikisht duke luftuar në rrethim me fashistët, komandanti i njësiteve guerile të Tiranës, Heroi i Popullit Vojo Kushi, bashkë me shokët e tij Xhorxhi Martini dhe Sadik Stavaleci, në shtëpinë e qytetares Ije Farka.
- **9 tetor 1943** - U formua në Pezë Brigada e III-të S. e UNÇISH
- **10 tetor 1943** - U formua Batalioni i Pezës.
- **10 tetor 1943** - U formua Batalioni "Antonio Gramshi" i përbërë prej 170 vullnetarësh proletarë italianë. Nga ky batalion ranë dëshmorë 15 partizanë, kurse 24 të tjerë u plagosën.
- **10 tetor 1944** - U formua Divizioni i III-të S. i U.N.ÇI.SH., i përbërë nga Brigada 12-të, 14-të dhe e 19-të S.
- **11 tetor 1925** - Lindi në Tiranë Heroi i Popullit Myslim Keta.
- **11 tetor 1944** - U çlirua qyteti i Sarandës prej Brigadës 12-të e 14-të S.
- **13 tetor 1944** - Brigada III dhe V Sulmuese të U.N.ÇI.SH. kaluan kufirin për çlirimin e Kosovës nga pushtuesit fashistë.
- **15 tetor 1944** - U çlirua qyteti i Vlorës prej partizanëve të Brigadës 12-të Sulmuese
- **16 tetor 1944** - U formua në Lozhan të Korçës Brigada e IX-të Sulmuese e U.N.ÇI.SH., prej batalioneve "Fuat Babani", "Reshit Çollaku", "Skënder Çaçi", "Tomorri" dhe "Hakmarra".
- **17 tetor 1944** - U çlirua qyteti i Kuçovës prej Brigadës VIII dhe XVI Sulmuese.
- **18 tetor 1943** - U qëllua me top pallati ku ishte mbledhur Asambleja Kuislinge, që do të legalizonte pushtimin e ri të Shqipërisë nga nazistët gjermanë, e cila shënon edhe ditën e armës së Artillerisë së Ushtrisë Shqiptare.
- **20 tetor 1942** - U formua çeta e Kolonjës.
- **20 tetor 1944** - U bë mbledhja e II-të e Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar.
- **24 tetor 1944** - U çlirua qyteti i Korçës.
- **28 tetor 1940** - Italia fashiste sulmoi Greqinë.
- **28 tetor 1941** - Demonstratë e madhe antifashite në Tiranë.

luftarak vazhdoi në zonën e Skraparit dhe Përmetit. Gjatë luftimeve që u zhvilluan në Sukën e Përmetit, të drejtuara nga "Heroi i Popullit" Myslim Keta, iu shkaktua armikut një humbje e madhe dhe u bë e mundur të shpëtohet jeta e 17 fshatarëve, që ishin të zënë robër e që do të pushkatoheshin.

Brigada mori detyrë që në përbërje të Divizionit të I-rë Sulmues, me luftime të marshonte në drejtim të Verilindjes, Tiranë-Martanesh-Peshkopi-Kukës-Has dhe për në Malësinë e Gjakovës, nëpër një terren shumë ët thyer e malor, duke kaluar Drinin e Zi e Drinin e Bardhë, në një dimër të ashpër.

Në bashkëpunim me Brigadën e V-të Sulmuese, luftime të ashpra kemi zhvilluar në zonën e Peshkopisë e të Kukësit.

Me çlirimin e Tropojës në Tetor, luftime shumë të ashpra e të përgjakshme janë zhvilluar në zonën e Junikut në Kosovë, për çlirimin e Rrafshit të Dukagjinit, të qytetit të Gjakovës e të Pejës.

Detyrat luftarake i kemi vazhduar në drejtim të Malit të Zi e deri në Sanxhak të ish Jugosllavisë.

Heroizmi luftarak, trimëria deri në përlëshje me armikun, dashuria deri në vdekje mes partizanëve ishin cilësitë e vjera të efektivit.

Në luftime dhanë jetën shumë partizanë e patrizane të kësaj brigade si "Heroina e Popullit" Ylberë Bylikbashi, komisarir Birçe Sinomati, dëshmorët Kapo Ademi, Kozma Papa, Sali Ymeri, Ali Dervishi e shumë të tjerë.

Në Dhjetor të vitit 1945, brigada kthehet në Atdhe duke plotësuar detyrat për çlirimin e Atdheut, gjithashtu edhe në ndihmë të popujve të ish-Jugosllavisë, udhëheqja e së cilës asnjëherë nuk i vlerësoi veprimet luftarake të brigadave e divizioneve tona partizane, pa ndihmën e të cilave do të vështirësohej çlirimi i jugosllavisë. Përkundrazi, udhëheqja e Beogradit, për gjysmë shekulli, shfrytëzoi dhe keqtrajtoi barabarisht popullin shqiptar të Kosovës, duke kaluar deri në genocid dhe asgjësimin fizik të tij.

Falë rezistencës kosovare, ndihmës politike, diplomatike e deri me ndërhyrjen ushtarake të NATO-s dhe mbështetjes së madhe të shtetit e të popullit Shqiptar, Kosova arriti pavarësinë e shumëkërkuar.

BRIGADA XXIV SULMUESE E UNÇSH LUFTOI PËR ÇLIRIMIN E SHKODRËS DHE NË MAL TË ZI

Në këtë 78 vjetor të krijimit të Brigadës 24/S veteranët, pasardhësit e tyre, të familjeve të dëshmorëve e invalidët e LANÇ dhe gjithë populli i Kukësit sjellin në kujtesë rrugën historike e luftarake të Brigadës 24/S, plot sakrificë, privacione dhe heroizma në gjithë inkursionin luftarak të saj kundër nazifashizmit dhe bashkëpunëtorëve të tyre dhe plot respekt e mirënjohje komandantit Ndrekë Rino, komisarit Abedin Shehu dhe gjithë kuadrin drejtues që nga Abaz Arif Shehu, Muheidin Kërzhaliu, Rasim Guri, Hysni Dino, Hasan Myftari, Vehbi Shehu, Ismail Loka, Hasan Spahiu, Rrah-

man Palushi, Ahmet Onuzi, Nexhip Visha, Ymer Domi, Ahmet Ramallari, Hysni Shehu, Maliq Gashi, Sinan Hajdari, Haxhi Sinomati e Hazir Asllani. Respekt e mirënjohje gjithë partizanëve të Brigadës që nga Abedin Shehu i pari në listën emërore e deri tek Destan Mici në fund të 1182 partizanëve, lavdi gjithë partizanëve që luftuan për një ideal të madh Lirinë duke e nënshkruar me gjakun e 43 dëshmorëve.

Gjatë muajit tetor 1944 Brigada e 24 S ndoqi këto probleme të veprimit të saj në të gjithë fshatrat e Kukësit siç ishin: Krijimi i Këshillave NÇ për të ndihmuar LANÇ, punë sqar-

uese për situatën dhe bindëse për plotësimin e batalioneve me partizan vullnetar e të mobilizuar, lidhja e popullit të Kukësit me Frontin N-Ç duke e shkëputur përfundimisht nga influenca e Muharrem Bajraktarit. Grushtet e Brigadës ndaj lëvizjeve të kolonave gjermane në rrugën Kukës-Prizren mbi postat armike në afërsi të qytetit të vjetër të Kukësit, mbi mercenarët etj.

Me urdhët të Shtabit të Përgjithshëm të UNÇ më 31 tetor 1944 Brigada e 24/S së bashku me Brigadën e 18/S i prenë rrugën Prizren-Kukës lëvizjes së kolonave gjermane. Më 8 nëntor Brigada e 24/S pasi përshën-

detet me banorët e Kukësit dhe të afërmit e tyre me urimin "U kthefshi me liri në ballë" u nisën për marshim të gjatë në rrugën luftarake - heroike drejt Tiranës, ku morën urdhërin luftarak për vendosjen gjatë rrugës Durrës-Tiranë me detyrë bllokimin e saj për të mos lejuar hyrjen ose daljen e forcave gjermane nga Tirana.

Të gjithë Batalionet e Brigadës bënë luftë vetëmohuese duke i shkaktuar armikut humbje të mëdha në njerëz dhe teknikë. Batalioni i parë sulmoi depon e karburantit. Lufta vazhdoi pandërprerje ditë e natë prej datës 11-

78-VJETORI

24 TETOR 1944, SULMI I FORCAVE TË BRIGADËS IX DHE XX PËR SHPORRJEN E NAZISTËVE GJERMANË NGA QYTETI JUGOR

Historiku i Brigadës IX Sulmuese

Brigada IX Sulmuese u formua në katundin Lozhan të Gorës, qarku i Korçës, më 16 tetor 1944. Komandant Irakli Bozo dhe Komisar Mihallaq Zicishti.

Në përbërje të saj kjo brigadë kishte pesë batalione sulmues, të cilët kishin përvojë në artin e luftës. Në kohën kur u krijua brigada, shumë vende të Evropës Lindore po çliroheshin nga ushtria sovjetike, pra brigada IX i shtoi radhët e ushtrisë shqiptare, duke bërë të mundur çlirimin e vendit me forcat tërësisht vendase.

Kjo brigadë u krijua me qëllimin e shtimit të veprimeve ushtarake në zonën e Korçës. Detyra ishte të eliminonte autokolonat armike që lëviznin në aksin Janinë-Korçë-Manastir-Follorinë, Korçë-Pogradec-Tiranë, por detyra më e rëndësishme ishte çlirimi i qyteteve të Korçës, Ersekës dhe Bilishtit. Me marrjen e këtyre qyteteve armikut u pritshin rrugët e komunikacionit dhe paralizoheshin tërheqja e ushtrisë gjermane nga Greqia për në Jugosllavi nëpërmjet territori shqiptar. Urdhri për krijimin e brigadës u dha nga Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Nacionalçlirimtare. Në përbërje të tij u caktuan batalione me përvojë në luftë kundër pushtuesve. Inaugurimi i brigadës u bë para efektivit të saj ku u rreshtuan të gjithë batalionet e saj.

Brigada kishte një armatim që dispononte e gjithë ushtria shqiptare në atë moment, ajo kishte armë të dhurara nga populli, por edhe nga ndihmat aleate të hedhura me parashutë, si armë automatike, por që nuk plotësonin të gjithë numrin e pjesëtarëve të brigadës. Brigada ishte e pajisur me shërbim shëndetësor. Pranë shtabit të brigadës qëndronte një mjek dhe 2-3 infermiere vullnetare. Shtabi i brigadës ishte i përbërë nga Irakli Bozo, komandant; Mihallaq Zicishti, komisar; Petro Papi; zv/komisar; Meleq Babani, përgjegjës rinie dhe Vangjel Marko, in-tendent.

Pas ngritjes së Shtabit Operativ për çlirimin e Korçës, Brigada IX, që përbënte dhe një nga forcat kryesore pjesëmarrëse në operacion, kishte në përbërje të saj 1580 partizanë. E gjithë forca partizane në zonën e Korçës arrinte në 3000 veta, po të shtohen këtu edhe partizanët e Brigadës II me 1150, dhe brigada e XX-të me 430. Këtu mund të shtojmë edhe forcat guerile që vepronin brenda në qytete, si në Korçë dhe Bilisht, të cilat arrinin në rreth 1000 vetë.

Forcat armike që kontrollonin zonën e Korçës ishin më të pakta në numër, por të pajisura dhe mbështetura në tanke dhe artileri. Këto forca armike kishin nën kontroll vetëm rrugët kryesore dhe duhej të siguronin tërheqjen e forcave gjermane nga Greqia në Jugosllavi, e cila përbëhej nga Korpamata e 21. Në bazë të urdhrave të Shtabit të Operacionit, batalionet e brigadës morën të gjithë detyra të ndryshme në zona të ndryshme në bashkëpunim me batalionet e brigadave ndihmëse. Batalioni I u caktua të asgjësonte garnizonin e Kolonjës dhe Leskovikut. Batalioni i II-të duhej të kontrollonte disa prej katundeve që kishin pranë rrugën automobilistike Qafë e Qarrit-Korçë. Batalioni III duhet të sulmonte garnizonin e Bilishtit dhe të kontrollonte kufirin në zonën e Kapshticës. Batalioni IV në bashkëpunim me batalionin e I të brigadës së II duhej të sulmonte garnizonin e qytetit të Korçës dhe çlirimin përfundimtar të qytetit. Disa prej tyre edhe u diktuan në momentin kur dhe do të zinin pozicionet e luftimit, ata u goditën nga zjarri i artilerisë armike. Katër batalionet e brigadës u vendosën sipas urdhrave në pozicionet e caktuara. Të parët që u ndeshën me forcat armike ishin partizanët e batalionit I, të cilët



mundën të futeshin thellë në linjat armike.

Nga Janina po tërhiqej një autokolonë e madhe me gjermanë, të cilët rrugës do të mblidhnin edhe disa nga garnizonet që kishin në Leskovik, Korçë dhe Bilisht. Kjo autokolonë u sulmua nga batalioni I i Brigadës IX në bashkëpunim me batalionin II të Brigadës II. Lufta ishte e ashpër, me sulme e kundërsulme, por falë errësirës, autokolona arriti të dalë nga rrethimi dhe të largohet në drejtim të Korçës.

Ky largim i gjermanëve lejoi që forcat partizane të futën në qytetet e Leskovikut dhe Ersekës. Në mesin e tetorit forcat partizane kishin nën kontroll të gjithë krahinën e Kolonjës, në dorë të tyre kishin rënë shumë materiale ushtarake të lëna nga armiku në ikje e sipër.

Të katër batalionet raportonin suksese në zonat ku ishin caktuar. Ato filluan sulmin kundër forcave gjermane që gjendeshin të pozicionuara jashtë Korçës, duke pasur sukses dhe duke shkaktuar panik midis armikut. Kjo bëri që ato të tërhiqeshin në mënyrë të çrregullt drejt Korçës. Batalioni i katërt tentoi me sukses edhe bllokimin e rrugës Korçë-Pogradec, kjo i detyroi forcat naziste të mos kishin asnjë komunikim me forcat jashtë, duke shuar edhe shpresën për ndonjë ndihmë të mundshme. Ky ishte një sukses në fushën e betejës për dy brigadat që organizuan sulmin. Suksesi ishte edhe për komandën e brigadës, e cila kishte vetëm pak kohë që ishte krijuar.

Në bashkëpunim me Brigadën II, Brigada IX iu afrua lagjeve të jashtme të Korçës. Menjëherë mbi qytet filluan sulme të organizuar me qëllim shqetësimin e armikut. Duke e zgjatur vijën e luftës, partizanët po ngushtonin rrethimin e armikut. Të gjendur në dëshpërim gjermanët tentonin të tërhiqeshin prapa, andej nga kishin ardhur, nga kufiri grek. Forcat zbuluese partizane mundën të lokalizojnë saktësisht vendosjen e armikut dhe mënyrën se si mbroheshin. E gjithë kjo u arrit në bashkëpunim me forcat guerile që



ndodheshin në qytet. U dha urdhër që rrethimi të ngushtohej edhe më shumë, forcat partizane intensifikuan sulmet, ato arritën deri në pazarin e qytetit, duke u ndeshur dhe trup me trup me gjermanët.

Kjo i detyroi gjermanët që ta përqendroni çarjen e rrethimit në një pikë, verilindjen. U përdorën të gjitha armët e mundshme, që nga artileria dhe autobлиндat. Ata filluan të hidhnin në erë shumë pika strategjike të qytetit, por sidomos edhe depon e municioneve shpërthimi i së cilës shkaktoi një gjendje alarmi. Gjermanët kishin lënë vetëm një shteg për t'u tërhequr, shteg, i cili u bllokua menjëherë nga forcat partizane. Vetëm një pjesë e tyre mundi të shpëtojë dhe të largohet nga qyteti. Pjesa tjetër u vra ose u kap rob nga partizanët. Ky ishte edhe sulmi i fundit i partizanëve, të cilët mundët ta çlironin përfundimisht qytetin e Korçës. Mbetej të bëhej edhe çminimi i zonave të pashpërthyer, operacion që u krye në bashkëpunim me njësitet guerile të qytetit. I gjithë qëllimi i gjermanëve ishte të hidhej në erë qyteti i Korçës, që forcat naziste të kishin mundësi të largoheshin të pa shqetësuar.

Menjëherë forcat partizane dhe më saktësisht batalioni I i brigadës së IX dhe ai I i brigadës së II, u vunë në ndjekje të forcave armike. Forcat parti-

zane iu drejtuan qytetit të Bilishtit, i cili mbahej akoma nga forca naziste. Qyteti u rrethua, por partizanët u gjendën përballë një sulmi të artilerisë armike. Pas shumë përpjekjesh partizanët i detyruan gjermanët të tërhiqeshin nga pozicionet e zjarrit dhe të strukeshin në kazemat e qytetit. I gjithë sulmi vazhdoi tërë natën e 25 tetorit duke i bërë gjermanët të tërhiqeshin drejt kufirit grek.

Edhe pse dolën nga kufiri shqiptar gjermanët u ndoqën dhe u sulmuan duke u shpartalluar përfundimisht. Partizanët e Brigadës IX u futën dhe ndihmuan popullin grek nga forcat gjermane, në katundet Drenovon. Operacionet për çlirimin e Korçës u kryen në një kohë të shpejtë. Kjo ishte rezultati i bashkëpunimit me batalionet e tjera të Brigadës II. Populli i Korçës iu rezervoi një pritje të madhe partizanëve kur këta u futën në qytet për nder të tyre u organizuan koncerte e festime. Populli i Korçës doli i gjithi nëpër rrugë dhe festoi me partizanët çlirimin e qytetit. Kori i qytetit për nder të kësaj ngjarjeje këndoi këngë patriotike, sidomos një këngë e cila ishte përgatitur posaçërisht për këtë ditë.

Por shfaqje të tilla gëzimi kishte edhe në qytetet e tjera si Bilishti dhe gjithë qarkun e Korçës, të cilat zgjatën tërë natën deri në mëngjes.

Menjëherë pas çlirimit të qarkut të Korçës, me urdhër të Shtabit të Përgjithshëm, dy nga batalionet e brigadës IX u vendosën në mbrojtje të qytetit të Korçës dhe dy të tjerë në mbrojtje të qytetit të Bilishtit. Detyrë ishte edhe mbrojtja e kufirit me Greqinë, e cila po mbante një qëndrim agresiv ndaj popullit shqiptar sidomos çamëve. Pas qetësimit të gjendjes forcat e Brigadës IX, që tashmë kishin hyrë në përbërje të Divizionit të IV, morën urdhër të largohen nga qarku i Korçës dhe të vendosen në Shqipërinë e Mesme në rajoni Krujë-Ishëm-Kavajë.



BRIGADA XXIV SULMUESE E UNÇSH LUFTOI PËR ÇLIRIMIN E SHKODRËS DHE NË MAL TË ZI

(Vijon nga faqja 4)

17 Nëntor 1944, kur u çlirua përfundimisht Tirana. Detyrën luftarake e kryen me sukses, por lanë në fushën e betejës 15 partizanë nga Kukësi: Abaz Pëposhi, Dan Shahu, Elmaz Ademi, Gani Duraku, Hakik Gjici, Idriz Gafurri, Maksut Rexhepi, Nuredin Braha, Osman Qenami, Ramadan Kotarja, Sabri Gjici, Sadik Palushi, Xheladin Mici Vehbi Shehu dhe Sherif Smana.

Pas çlirimit të Tiranës më 17 Nëntor 1944 u ngarkua me detyrë të ndiqte armiku në drejtim të Shkodrës, duke kaluar Milotin e Lezhën.

Më datën 23 nëntor 1944 rreshtohet Brigada nën komandën e Ndreko Rinos, për të marrë detyrën luftarake dhe sqarimin e saj për asgjësimin e forcave gjermane duke kaluar edhe lumin e Matit dhe të Drinit për në

Shkodër. Më datën 24 nëntor brigada mbërrin në Bërdicë e Beltojë me zhvillime të përgjakshme luftimi ku bien dëshmorë: Emri Halilaj, Hasan Lika, Islam Xhahu, Isuf Seferi, Ymer Mata. Më datën 28 Nëntor morën Baçellëkun, kaluan Drinin dhe gjatë natës së 28-29 Nëntorit u bë luftë vendimtare, ku mëngjesin e datës 29 Nëntor Shkodra u çlirua. Fitorja më e madhe dhe e lavdishme e gjithë popullit shqiptar.

Më datën 1 Dhjetor 1944 Brigada u nis për në Mal të Zi, Ulqin e Tivar. Meqë nazistët gjermanë ishin larguar nga Tivari më 6 Dhjetor Brigada u kthye në Shkodër dhe mori detyrë për të vepruar në Malësinë e Madhe, Dukagjin e Kastrat dhe bjeshkët e Kelmendit për të ndjekë e shpartalluar bandat armike të komanduara nga krerët e reaksionit vendas si Id-

riz Jazo, Llesh Marashi e Prek Cali. Ndjekja e shpartallimi i këtyre bandave u bë në kushte të vështira dimri e terreni. Nga luftimet e batalionit të Katërt të Brigadës ranë dëshmorë: Gani Onuzi, Hysen Koka, Halil Hasa, Ibrahim Lleshi, Mahmut Neçi, Musli Halilaj, Ramadan Kaculi dhe Rustem Shehu. Në pranverën e vitit 1945 mbasi Brigada e 24/S kreu me sukses detyrat luftarake vazhdoi marshimin në drejtim të Tiranës ku më 15 Maj 1945 u shpëmda.

Nëpër një turne luftarak plot aksione shoqëruar me fitore Brigada e 24/S u ballafaqua me dinjitet dhe epërsi morale për luftën e saj të drejtë antifashiste dhe çlirimtare. Lumnjat në lëvizjet popullore dhe luftërat kanë pasur prijtarë e kapëdanë të mire, por si në UNÇ dhe në Brigadën e 24/S nuk kishte ndodhur asnjëherë.

DOSSIER

Ish-gardiani që më 1943 kishte shpërthyer burgun e Tiranës, bashkluftëtar i Myslim Pezës dhe Tuk Jakovës

Si shpëtoi Ramadan Gjoka nga përballja me Mehmet Shehun

- Në analizën vjetore, në fund të vitit 1956, në aparatën e Ministrisë së Brendshme, Lilo Zeneli (babai i Bashkim Zenelit), në diskutimin e tij do t'u drejtohej ministrit Mehmet Shehu dhe zv/ministrit Kadri Hazbiu: "Ju keni liruar nga organet tona padrejtësisht kuadrin më të aftë, shokun Ramadan Gjoka. Për katër vjet me radhë ai ka asgjësuar banda të rrezikshme e jo derra e dhi të egra, siç bëjnë disa të tjerë". Përgjigja do të ishte e menjëherëshme: "Na fal shoku Lilo, bëhen edhe gabime!"

Halil RAMA

Më katër nga nëntë fëmijët e Ramadan Gjokës nga Macukulli i Matit (Florën, Vladimirin, Ilirin dhe Yllin) kemi të njëjtën vendlindje, Muhurrit e Dibrës. Po këtu kemi bërë tetëvjeçaren, madje me Ladin kam qenë për katër vjet në të njëjtën klasë. Kjo rastësi ka të bëjë jo me shokët e miqtë e mi të ngushtë, vëndorigjina e të cilëve ishte rreth 50 km larg Muhurrit, por me babain e tyre, Ramadanin, që shërbeu dhe la emër të mirë në vendlindjen time për 14 vjet (1957-1971). Dhe ndonëse, bazuar në bilancin tragjik të viktimit të genocidit komunist, shumë bashkëkohës të tij janë ende nën akuzë, me Ramadan Gjokën si një nga ish - punëtorët operativë për më shumë se një dekadë në zonën time, ndodh e kundërta. Ka kaluar gjysmë shekulli që kur është larguar nga lokaliteti i Muhurrit (në përberje të të cilit ishte edhe Luznia, por që Ramadan mbulonte edhe Selishtën, Lukanin, Qafë Murrën e Kacninë) dhe Ai kujtohet me nderim të veçantë. Kjo, për faktin se krijoi lidhje të ngushta me komunitetin dhe në asnjë rast nuk tregoi «grushtin e hekurt», por edhe kur nga lart e urdhëronin të kryente ndonjë ndëshkim të pamërituar ndaj ndonjërit, do të gjente mënyra efektive për ta mbrojtur, madje edhe duke e lajmëruar që të «arritet» për disa ditë. Ndaj dhe u bë dhe mbeti simbol i mirësisë, urtësisë, mençurisë e trimërisë, virtyte këto të trashëguara, por edhe të kalitura në karakterin e tij, si gjatë Luftës Nacionalçlirimtare edhe në vitet e pasçlirimit kur kreu me devotshmëri e përkushtim të rrallë detyra e funksione të rëndësishme në disa rrethe të vendit.

Pikërisht pse radhitet ndër personalitetet me emër të spikatur në panteonin e vlerave tona kombëtare, më i madhi nga djemtë e tij, Petriti, (një ish ushtarak me emër, autor edhe i librit me poezi «Rruga është e gjatë») e ka skalitur mjeshtërisht portretin e babait, si një nga personazhet kryesorë të librit «Rexhep Haxhiu i Macukullit».

RAMADAN GJOKA, NDËR ATA QË SHPËRTHYEN BURGUN E TIRANËS

Ramadan Rexhep Gjoka lindi më 10 prill 1921 në Macukull të rrethit të Matit, në një familje të varfër fshatare. Mësimet e para për shkrim dhe këndim i mori nga mësuesit e parë të fshatit, Halit Kryekurti, Hasan Demiri e Mustafa Neli.

Jeta e vështirë ekonomike në fshat do e detyronte babain e tij Rexhepin, që nga viti 1933, Ramadanin dhe vëllain e tij Saliun, t'i sistemonin në punë të ndryshme në Tiranë dhe në Durrës.

Në Tiranë, Ramadan banonte në lagjen e Jorganxhinjve, lagja Tabakaj, sot «Ali Demi». Tek furra e Shaban Kazazit, ai bie në kontakt me shokët Rexhep Hani e Ali Demi dhe aktivizohet me grupet e para guerrile antifashiste.

Në vitin 1942, me porosi të shokëve Rexhep Hani e Xhemal Punavija, bashkë me shokun e tij Musa Dani nga Lisi i Matit, vishen gardianë në burgun e Tiranës. Aty gjen të veshur gardianë edhe dy bashkëfshatarët e tij Dem Dinin e Ahmet Canin, megjithëse ata nuk pranuan të bashkëpunonin, por u zotuan se do të qëndronin të heshtur dhe asnjëherë. Asnjëherë e tyre që ndihmë dhe meriton të vlerësohet. Ndërkohë, Ramadan dhe Musai

siguronin ndërlidhjen midis njësiteve guerrile e të burgosurve antifashistë që ishin në burg, shpërndanin trakte, furnizonin me mjete pune si dalta, tuba, ruanin gjatë gërmimit të tunelit dhe fshihnin dheun, veprime këto që kërkonin kujdes, guxim e trimëri.

Aksioni përfundoi me sukses të plotë. Më 26 prill 1943, arratisen nga burgun nëpërmjet tunelit 28 të burgosur, si Koçi Xoxe, Sejdin Avdia etj. (I biri i tij Petrit R. Gjoka shkruan në librin «Rexhep Haxhiu i Macukullit», se «para se të xhirohej filmi 'Njësi guerril', skenaristi e regjisorin nga Kinostudio 'Shqipëria e Re' kanë vajtur në Burrel dhe kanë intervistuar Ramadan Gjokën e Musa Danin».

Pas shpërthimit të burgut të Tiranës, Ramadan e Musai inkuadrohen në çetën partizanë të Pezës, ku do të njiheshin e bashkëvepronin me partizanë të vjetër, si Shem Kolli, Nuz Hakrama, Shaban Rexha, Pandi Nezha, Shyqyri Peza, Xhaferr Vokshi, Ziso Dako, me Babë Myslimin e Kajo Karafilin.

Në Çetën partizane të Pezës, me komisar Mahmut Agollin dhe komandant Nuz Hakrama, Ramadan tregon vendosmëri e trimëri, që në aksionet e para.

Nami dhe trimëria e dy matjanëve në Pezë, Ramadan Gjoka e Musa Dani, kish vajtur gjer në Mat, në vendlindjen e tyre. Komisari i Çetës së Matit Mustafa Kaçaçi, do t'i kish kërkuar Myslim Pezës transferimin e tyre në Mat, por Babë Myslimi, shkurt, prerë dhe qartë do i përgjigje: «Në asnjë mënyrë, ata i kam më trimat e Pezës».

Me organizimin e ri të formacioneve partizane, inkuadrohet në batalionin e I-rë të Grupit të Pezës, me komandant Fadil Dashi dhe komisar Maliq Muça. Nga partizan i thjeshtë arrin të caktohet komandant skuadre, toge e deri zëvendëskomandant kompanie.

AKSIONET LUFTARAKE KU MORI PJESË TRIMËRISHT RAMADAN GJOKA

Ramadan Gjoka gjatë LANÇ ka marrë pjesë në këto aksione kryesore:

Në 14 Qershor 1943, në Qafë Helmës.

Në qershor 1943, me një grup partizanësh të zgjedhur me komandant njësi Kajo Karafilin, merr pjesë në kryerjen e një aksioni të rëndësishëm, në Pezë të Vogël kundër fashistëve italianë.

Nga fundi i muajit korrik 1943, me detyrë komandant toge ngarkohet me ruajtjen e Shtabit të Përgjithshëm që ishte dislokuar në Arbanë, në shtëpinë e Petrit Arbanës.

Në gusht 1943 merr pjesë në kapjen e 50 mercenarëve, në Qafë Krrabë.

Në tetor 1943, merr pjesë në luftimet në Domjan dhe Arbanë të Tiranës.

Në nëntor 1943, merr pjesë në luftimet kundër gjermanëve në Petrelë e Krrabë.

Në librin «Rexhep Haxhiu i Macukullit» (faqe 106), referuar kujtimeve të Ramadanit mësojmë se: «Në Operacionin armik të Dimrit 1943-1944, njësi partizan, me Andrea Mema nga Korça, Ramadan Gjoka nga Macukulli, Ramazan Abazi dhe Ibrahim Osmani nga Burgajeti i Matit dhe motra e Xhevdet Petrelës, dhe kjo partizane, gjatë një aksioni në zonën e Krrabës, u gjenden të rrethuar nga forcat gjermane e balliste. Binte shi dhe dëborë. Për t'i shpëtuar rrethimit u futëm në lumin Erzen, u maskuam me mjete rrethore dhe vetëm kokat kishim mbi ujë. Qëndruam mbi 10 orë. Pas largimit të gjermanëve natën, ne vazhduam lëvizjen dhe arritëm në Pezë shëndoshë e mirë. Myslim Peza na falenderoi për taktikën që kishim përdorur, për ruajtjen e shoqës partizane dhe të armëve».

Nga qëndrimi në ujë e shi për disa orë, Ramadan do të merrte ftohje të rëndë që nuk do t'i ndahej gjatë gjithë jetës. Ilegalisht, në janar 1944 do të shtrohej në spitalin e Tiranës i maskuar si fshatar pezak. Pas 10 ditësh, pa u shëruar plotësisht do të rikthehej në Pezë.

(Bashkëkohësit kujtojnë se edhe pas çlirimit, ai do të shtrohej në spital disa herë si në Tiranë, Kukës e Peshkopi dhe sa bëhej më mirë kthehej në punë. Madje, disa herë u thoshte djemve se plaga e ftohjes i dhemb më shumë nga plaga e plumbit të gjermanit).

Në maj 1944 merr pjesë në luftime në Kazisaj të Peqinit.

Në 1 qershor 1944, batalioni partizan ndeshet me



gjermanë e ballistë në German të Kavajës, ku Ramadan plagoset rëndë. Në këtë betejë është vrarë komisar i Batalionit Maliq Muça.

Referuar sërish kujtimeve të Ramadanit në librin e Petrit R. Gjokës «Rexhep Haxhiu i Macukullit», (fq. 107) mësojmë se ai ia dinte për nder shokut të tij të luftës, Tahir Minxhozit, që e mbajti në krah dhe e nxori nga luftimi. Madje, disa herë, megjithë dhimbjet e mëdha që kishte, pasi këmbën nuk e ndjente veçse i kullonte gjak, i thoshte Tahirit ta lëshojë, pasi kërcënohej edhe jeta e tij. Por dashuria për shokun gjatë luftës partizane qëndronte në shkallën më të lartë.

Në spitalin partizan të Pezës qëndroi 4 muaj. Operacionin për nxjerrjen e plumbit nga këmba ia ka bërë doktor Petro Cani në kushte mjaft primitive. Gjatë gjithë kohës së operacionit me sharrë druri, nuk lëshonte klithma, por vetëm shtërgonte veten, kërciste dhëmbët e kafshonte një shkop druri që mbante në gojë. Ardhja e nënës së rij në spitalin partizan e çuditi pa masë, e bëri me krahë, pasi përjetoi dashurinë e saj për të birin, sakrificat dhe guximin e saj. Ishte ky udhëtim heroik e historik i nënës së tij që lidhi luftën e Macukullit me Pezën partizane...

Me shërimin e tij të pjesshëm, në shtator 1944 Ramadan Gjoka rikthehet në formacionet partizane, inkuadrohet në Brigadën e XXII Sulmuese me komandant Sali Verdha e komisar Tuk Jakova.

Merr pjesë në marshimin e Brigadës për në Veri në intenerarin Pezë-Tiranë-Qafë Shtamë-Burrel-Vinjoll-Kacni-Lukan-Lurë.

Me urdhër të Komandës së Brigadës ngarkohet me detyrë delegat politik në Lurë, ku gjen mbështetje tek Llan Kaci e Sadik Tollja; rigjallëron jetën dhe aktivitetin e këshillave Nacionalçlirimtare. Në Lurë, sëbashku me vëllain e tij, Kurt Gjokën krijojnë 5 organizata rinie antifashiste Nacionalçlirimtare. Pas qëndrimit për një kohë të shkurtër në Lurë transferohet delegat politik në Klos të Matit.

KRYETARI I PARË I KOOPERATIVËS BUJQËSORE TË SUÇIT

Pas çlirimit të vendit nga okupatori nazifashist, në harkun kohor të 11 viteve (1945-1956) Ramadan Gjoka punon në organet e Punëve të Brendshme në zonat Mat-Mirditë-Zerqan-Tropojë-Kukës; arrin me gradën Kapiten i Parë.

Në prill 1956 lirohet nga organet e Punëve të Brendshme dhe emërohet kryetari i parë i Kooperativës Bujqësore në Suç të rrethit të Matit. Ndonëse nuk ishte specialist bujqësie, në saj të mirëorganizimit të punëve, duke udhëhequr me ndershmëri e shembull personal e duke krijuar lidhje mjaft të ngushta me kooperativ-

(Vijon në faqen 7)



Ramadan Gjoka me familjen

IN MEMORIAM

Luftoi për çlirimin e vendit dhe ra dëshmor në moshën më të re, ende pa mbushur 18 vjeç

SEZAI SURROI, SIMBOLI I VLERAVE PATRIOTIKE DHE LIRIDASHËSE

Shkolla e mesme "Sezai Surroi" në Bujanoc është institucioni i vetëm i shkollimit në gjuhën shqipe në Luginën e Preshevës. Sezai është vëllai i shkrimtarit, politikanit dhe diplomatit Rexhai Surroi, axha i publicistit të njohur Veton Surroi dhe gazetares e drejtoreshës së kompanisë botuese dhe mediale "Koha Group", Flaka Surroi

Nga Bashkim Hisari

Në vitet e Luftës së Dytë Botërore, qyteti dhe rrethina e Prizrenit përjetuan zhvillime dhe ngjarrje me të gjitha tiparet e luftës shkatërrimore. Shumica e prizrenasve mbështetën pa rezerva Lëvizjen Antifashiste Nacionalçlirimtare. Ata që u bashkuan aradhave partizane dhanë kontribut me vlera në rezistencën antifashiste dhe shprehën fuqimisht vlerat patriotike dhe liridashëse. Të gjithë me përkushtim e idealizëm kërkonin më tepër drejtësi, liri dhe prosperitet. Meritë të veçantë në këtë drejtim patën të rinjtë prizrenas. Ndër ta, shembulli i Sezai Surroit është unik. Ai u rreshtua në radhët e partizanëve si 15 vjeçar, luftoi për çlirimin e vendit dhe ra dëshmor në moshën më të re, ende pa mbushur 18 vjeç.


Pikërisht në verën e vitit 1944 kur forcat partizane shënonin fitore të njëpasnjëshme kundër fashizmit, gjermanët në shenjë hakmarrje, në mënyrë çnjerzore ushtronin dhunë duke kryer terror, vrasje, masakre të pjestarëve të njërive partizane dhe atdhetarëve.

Më 30 gusht të vitit 1944, në shenjë hakmarrjeje, në qendër të Prizrenit nazistët gjermanë vranë dhe varën 10



pjesëtarë të Lëvizjes Antifashiste Nacionalçlirimtare, të cilët i sollën nga kampi famëkeq i shfarosjes në masë, që ishte ngritur në kodër në një stallë kuajsh në periferi të Prishtinës, ku gjermanët masakruan 104 dëshmorë të popullit shqiptarë, të cilët më parë u detyruan ta hapnin vetë gropën e përbashkët ku pastaj u varrosën.

Mësuesi i ri Sezai Surroi, i lindur më vitin 1926 në Prizren, ishte njëri



prej viktimave të vrarë dhe të varur publikisht në qendër të qytetit të Prizrenit ku atëherë ndodhej Tregu i Drithërave, përpara hotelit të sotëm "Theranda". Aty deri në vitin 1999 qëndronte përmendorja që përkujtonte varjen e Surroit dhe heronjve të tjerë të asaj kohe.

Dita kur u varë Sezai Surroi bashkë me 9 bashkëlufëtar të tij, ishte një ditë që kalonte përtej pikëllimit për të riun e rrallë me kontribut të jashtëzakon-

shëm për liri në shërbim të popullit, drejtësisë, mirësisë, emancipimit dhe ngritjes së shqiptarëve. "Atë ditë, që në orët e para të mëngjesit, në lagjen tone "Marash", me shpejtësi u përhap lajmi për vrasjen dhe varjen e partizanëve në qendër të qytetit" - tregon Beqir Firzi, vëllai i dëshmorit Nuredin Firzi i cili në atë kohë, ndonëse 9- vjeçar, me vrap kishte shkuar me pa viktimat. "Ishin 10 partizanë, kryesisht të rinj të vrarë dhe varur me litar rreth qafës dhe me duar të lidhura në mes dy shtyllave. Skaj viktimave ishin ushtarë të armatosur gjermanë, të cilët vetëm qëndronin derisa njerëzit kalonin aty pranë dhe me dhimbje shikonin viktimat. Ishte një pamje e tmerrshme që nuk mund ta harroj kurrë"

Sezai Surroi, shkollë fillore e kishte kryer në vendlindje. Në shtator të 1941 regjistrohet në gjimnazin e Prishtinës. Aty futet në grupet e rinisë dhe merr pjesë në të gjitha aksionet kundër okupatorit që kryeshin në shkollë. Në vitin 1942 regjistrohet në një kurs pedagogjik, ku aftësoheshin të rinj në mësimdhënien e gjuhës shqipe. Pas kursit fillon punë si mësues në fshatin Brrut të Opojës. Ishte mësuesi i parë i Shkollës së parë Shqipe në trevën e Opojës, shkollës e cila vuri themelet e arsimit shqip. Sezai, aty edhe më shumë dallohet në aktivitete për organizimin e çlirimit nga pushtuesit nazistë dhe shtypja serbe. Me tërë kapacitetin e tij nxit shqiptarët të marrin pjesë masivisht në luftë kundër padrejtësisë dhe okupatorit fashist. Burgoset për veprimtarinë e tij, pasi zbulohet nga pushtuesi, në vitin 1944.

Në librin e tij "Shkolla e parë shqip në Opojë", veterani i arsimit Ibrahim Skenderi shkruan: "Mësuesi i parë ka qenë Sezai Surroi, që i takon periudhës vendimtare dhe më të ndritshme të hapjes së 173 shkollave shqipe, 3 të mesme dhe disa Gjimnaze të ulëta në Kosovë". Padyshim këto shkolla kishin vlerë historike për popullin shqiptar të Kosovës. Në arrijtet në fushën e arsimit dhe të kulturës kontribut të pamohueshëm ka dhënë edhe komandanti i Shtabit të UNÇ dhe njërive e brigadave partizane në territorin e Kosovës, Fadil Hoxha dhe i besuari i Arsimit dhe Kulturës në Këshillin Ekzekutiv Krahinor Zekeria Rexha. Menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore, si përfaqësues të shqiptarëve të Kosovës ata shkuan në Tiranë ku u takuan me udhëheqësit më lartë shtetëror e partiak të Shqipërisë dhe ia dolën të sigurojnë për Kosovën nga Shqipëria më shumë se 200 mësues, tekste shkollore në gjuhën shqipe dhe shkronja të plumbta shqipe të nevojshme për shtypshkronjën e gazetës "Rilindja".

Sezai Surroi la një emër që ka vlera dhe respekt.

SHFMU në Bellobrad, të cilës i përket edhe paralelja në fshatin Brrut mbajnë emrin "Sezai Surroi. Qendra sportive në Prizren ku zhvillohen aktivitete të shumta sportive dhe kulturore po ashtu mban emrin e dëshmorit "Sezai Surroi". Ndërkaq, shkolla e mesme "Sezai Surroi" në Bujanoc është institucioni i vetëm i shkollimit në gjuhën shqipe në Luginën e Preshevës. Sezai është vëllai i shkrimtarit, politikanit dhe diplomatit Rexhai Surroi, axha i publicistit të njohur Veton Surroi dhe gazetares e drejtoreshës së kompanisë botuese dhe mediale "Koha Group", Flaka Surroi.

Si shpëtoi Ramadan Gjoka nga përballja me Mehmet Shehun



(Vijon nga faqja 6)

ishtë bëri të mundur që kjo kooperativë të kishte rezultate të larta në prodhim dhe të zinte vend të parë në gjithë rrethin e Matit.

SI I SHPËTOI PËRBALLJES ME MEHMET SHEHUN

Pasi përshkruan bukurinë fizike e shpirtërore të babait të tij, me trup mbi-mesatar, të drejtë dhe muskuloz, i pamposhur, fjalëzjarrtë, i papërtuar e i kundododhur, i vendosur, i ashpër ndaj mangësive e i thjeshtë mes të thjeshtëve; me karakter të fortë, të jashtëzakonshëm, trim e guximtar në luftë, gjatë e pas çlirimit, Petrit R.Gjoka, në librin e tij jep detaje nga përballja e Ramadan Gjokës me Mehmet Shehun (fq.126).

Në vitin 1949, Mehmet Shehu, asokohe, Ministër i Punëve të Brendshme, thërret në zyrë Ramadan Gjokën e do të drejtohej ashpër: "Ti Ramadan e babai yt Rexhepi, keni shpëtuar e nxjerrë nga rrethimi Bilal Kolën, dhe për këtë mbani

përgjegjësi të plotë. Përse nuk u dogi kulla juaj në Macukull si e Hasan Minxhozit në Shlli dhe e Haki Fejzos në Lis?"

Kuptohet, Ramadan mund të lirohej nga detyra, por dhe mund të merrej i pandehur si armik. Nuk kish rrugë tjetër. Ramadan vë dorën në brez e shtërngon pistoletën, e me ashpërsi i përgjigjet Mehmet Shehut: «Unë jam Ramadan Gjoka, kam shpërthyer burgun e Tiranës mes fashistëve, jam partizan i vjetër i Pezës, kam derdhur gjak për çlirimin e atdheut, me dhjetra herë jam ndeshur nëpër male me banda e kam dalë fitimtar, prandaj ato akuzat për mua e familjen time tërhiqi mbrapsht. Urgjentisht shoku ministër, kërkoi takim me Komandantin e Përgjithshëm, Shokun Enver Hoxha».

Mehmet Shehu, pas ulërimeve e të bërtiturave, duke parë vendosmërinë e karakterin e fortë burrëror të Ramadanit, ndryshoi taktikë: «Vazhdo punën, o Ramadan, armiqtë duan të na përcajjnë!».

Kryetari i Degës së Punëve të Brendshme, Burrel, asokohe Banush Goxhaj, do t'i drejtohej Ramadanit: «Të lumtë o Ramadan Gjoka, zbardhe faqen tënde, të familjes e të punës sonë në Mat».

RIKTHIMI NË STRUKTURAT E MINISTRISË SË BRENDSHME

Në analizën vjetore, në fund të vitit 1956, në aparatën e Ministrisë së Brendshme, Lilo Zeneli (babai i Bashkim Zenelit), në diskutimin e tij do t'u drejtohej ministrit Mehmet Shehu dhe zv/ministrit Kadri Hazbiu: "Ju keni liruar nga organet tona padrejtësisht kuadrin më të aftë, shokun Ramadan Gjoka. Për katër vjet me radhë ai ka asgjësuar banda të rrezikshme e jo derra e dhi të egra, siç bëjnë disa të tjerë". Përgjigja do të ishte e menjëherëshme: "Na fal shoku Lilo, bëhen edhe gabime!".

Reflektimi i titullarëve të dikasterit që i menjëherëshme dhe kështu, në fillim të vitit 1957 Ramadan Gjoka rikthehet përsëri në organet e Punëve të Brendshme në

zonën e Dibrës, ku shërbeu me devotshmëri e përkushtim të rrallë ndaj atdheut e shoqërisë për 14 vjet, deri sa doli në pension në vitin 1971.

Këto vite kur Ramadan Gjoka shërbeu në Dibër, në zonën e Muhurrit, Luznisë, Selishtës, Qafë Murrës, Lukanit, Kacnisë, Bulaçit, Rreth Kales, Pratit, Masdejës, Balxhajit, Shupenzës etj, si Operativ i Sigurimit, qenë mjaftë të suksesshme. Ai ishte model i bashkëpunimit me fshatarët e organet e policisë së shtetit. Arriti të marrë gradën e Majorit dhe shumë dekorata e lavdërime.

Profili i këtij luftëtari e qëndrestari të paepur ka frymëzuar dhjetra poetë, të cilët kanë shkruar e botuar për të poezi e balada. Njëri prej tyre, i mirënjohuri Mevlud Buci, burrit të Macukullit të Matit Ramadan Gjoka i ka kushtuar baladën me titull "Luftëtar me zë grykëholle" me 22 strofa (maj 2005). Meritë e veçantë e këtij personaliteti që rrezatonte kudo mirësi e paqe dhe që mishëronte vlerat më të mira njerëzore dhe intelektuale që dhe krijimi i një familjeje solide. Kështu, me bashkshorten e tij shembullore Mihane Gjoka (Doda) lindën, rritën, shkolluan dhe mirëedukuan shtatë djem dhe dy vajza: Petritin dhe Naimin, oficerë shembullorë të ushtrisë shqiptare, Shkëlzenin dhe Florën, nga mësuesit e drejtuesit e mirënjohur të arsimit në Mat e Tiranë, Natashën që si mjekë e Përgjithshme në Qendrën Shëndetësore Nr.2 Tiranë shërben me kompetencë, profesionalizëm e humanizëm ndaj komunitetit, dhe katër të tjerët: Kujtimi, Vladimiri, Iliri e Ylli mekanikë të talentuar të profileve të ndryshme.

Kanë kaluar 17 vjet nga dita e lamtumirës së tij (8 prill 2005) dhe jo vetëm nga familjarët, djemtë, vajzat, nipërit e mbesat e shumta, por edhe nga bashkëkohës e pasardhës të tyre në Dibër, Mat e Tiranë, Ramadan Gjoka kujtohet e nderohet për trashëgiminë e vyer që la pas, si pinjoll i një familjeje e fisi emërdritur.

IN MEMORIAM

SHTATË LAJTHIZAKËT – DËSHMORËT QË RANË PËR TRUALLIN ARBËROR

Dëshmorët janë qenie të shenjtëruar, të gjallë dhe të pavdekshëm. Ata jetojnë dhe lartësohen në valët e flamurit të kombit, përfshi këtu edhe të rënë për atdheun, pavarësisht nëse deri më sot janë një status juridik nga zyrat shtetërore. Në dhjetra e qindra shkrime në 107 vite është shkruar thjeshtë por saktësisht “..janë vrarë nga dora gjakatare serbe duke shoqëruar prijësin e kryengritjeve të mëdha trimin Ded Gjon Lulin. Ata ishin në një grup shoqëruar për një mision fisnik të përbashkimit në unitet luftarak të të gjithë krahinave veripore për tu mbrojtur nga sulmet e falangave serbe përgjatë Luftës së Parë Botërore. Emrat e “shtatë lajthizakëve”, ndrijnë në kujtesën e brezave dhe kujtohen ashtu sikurse përkujtohet trimi i maleve...”.

Ata janë të shpallur me titullin e lartë “Dëshmor i Atdheut”. Edhe në këtë 110 vjetorit të krijimit të shtetit shqiptar, do të përkujtohen ashtu sikurse përkujtohet kryetrimi Dedë Gjon Luli Dedvukaj (1840-24.9.1915), i cili ka qenë prijës e strateg i shquar i Malësisë së Mbishkodrës në luftën për çlirimin kombëtar dhe për ruajtjen e tërësisë territoriale të truallit arbëror. Ded Gjon Luli është i shpallur me titullin “Hero i Popullit” dhe “Dëshmor i Atdheut” me Vendim nr 129 dt 3.11.1969 të ish-Komitetit Ekzekutiv të Këshillit Popullor të Shkodrës, është dekoruar më 28.11.2015 nga Presidenti me “Urdhërin e Flamurit Kombëtar”, si bir i denjë i një trevë me atdhetari të spikatur, i lindur për komandant, luftëtar i vendosur për çështjen kombëtare shqiptare, si pjesëmarrës në LSHP më 1878, në Kuvendin e Greçës në 23.6.1911, që e lidhi jetën e tij dhe dy djemëve të tij Gjergjit dhe Kolës me fatet e Shqipërisë në periudhën kritike të saj. Ismail Qemali gjatë vizitës së tij në Vlorë pas shpalljes së Pavarësisë më 1912 e quajti “pushkë e ngrehur për Shqipërinë”, udhëheqës dhe luftëtar në Vermosh, në krejt veriun e trojeve shqiptare, ku e kërkonte interesi i kombit shqiptar, luftëtar për Hotin dhe Grudën, kundërshtar i vendimeve të traktatit të Shën Stefanit dhe të Kongresit të Berlinit, luftëtar për bashkim kombëtar.

Dy jave pas vrasjes së Dedë Gjon Lulit, trupat serbe dhe esadiste trupin e tij të pajetë e kishin mbuluar me lëndë drusore e gjethe në Malin Shejtë në Orosh, ku e zbuluan disa barinj rastësisht pas disa ditëve, ndërsa famulltari i Oroshit e varrosi te kisha e tij më datën 8.10.1915. Shtatë lajthizakët historinë e tyre e kanë pazgjidhshmërisht me trimin Ded Gjon Lulin, sepse që të shtatë u vranë nga dora e kriminelit serb kapiten Gjura, dhe kompania e tij të ushtarëve serbë që vepronin në zonën e Oroshit në Sheshëz. Luftëtarët lajthizakë që shoqëruan Ded Gjon Lulin, dhe morën vdekjen bashkë me të mbrojtjen nderin e Mirëditës, në mbrojtjen e heroit tonë kombëtar dhe idealeve të larta të përbashkimit. Ata i therën me bajoneta dhe i hodhën në

(Kushtuar dëshmorëve mirditorë, që ranë për lirinë e truallit shqiptar në të njëjtën ditë bashkë me Ded Gjon Lulin dhe në mbrojtje të tij, dhe që ndryshe në histori njihen si “shtatë dëshmorët lajthizakët”: Mark Llesh Doda (1876-1915), 39 vjeç, Llesh Ded Margjini (1874-1915), 41 vjeç, Mark Llesh Lleshi (1877-1915), 38 vjeç, Ndue Kol Pjetri (1875-1915), 40 vjeç, Ndue Kol Kola (1875-1915), 40 vjeç, Preng Çup Deda (1890-1915), 25 vjeç, Preng Çup Skania (1881-1915), 34 vjeç të vrarë nga dora gjakatare serbe më 24 shtator 1915. Ata u vranë nga pushtuesit serbë në mbrojtjen e heroit tonë kombëtar dhe nderit të Mirditës si dhe që të shtatë janë shpallur me titullin e lartë “Dëshmor i Atdheut” me Vendim nr. 78 datë 23 Maj 1978 (sipas origjinalit të librit: Dëshmorët e Atdheut, Tiranë, 2012, fq.145).

Prof. Asoc. Dr. Zaho GOLEMI

Shpellën e Akullit, në Malin e Shënjetit. Ata mbetën heroikë si klithma e bashkimit të trojeve shqiptare atje në shpellën e Akullit, mbetën stoikë me besë dhe për besën e shqiptarit, mbetën dëshmor në përjetësi. Besa, ky thesar i lashtë dhe unik për shqiptarët, ishte për shtatë lajthizakët jo vetëm kulti i fjalës së dhënë, por edhe thelbi i mitit biblik i thënies, “në fillim ishte fjala”. Luftëtarët lajthizakë, që të shtatë mendonin dhe gjykonin se me bacë Dedë Gjon Lulin nuk kishte kontratë me shkrim por vetëm besë burri, besë për mbrojtjen e truallit shqiptar, një kult madhështor i shqiptarëve, një ndër virtytet më të lashta të popullit shqiptar. Fjalën e dhënë për besë për kapëdanin e Malsisë ishte në fakt një betim solemn, një fjalë nderi e kunnit të maleve, por dhe një dashuri e përligjur për prijësin legjendë të Kryengritjeve të viteve 1911-1912, si

dhe legjendën e bashkimit kombëtar të trojeve shqiptare. Edhe në periudhën kur Shqipëria ishte vetëm një shtet 3 vjeçar dhe një shesh lufte besa vepronte tradicionalisht nësoj si për çështje personale, familjare, shoqërore e kombëtare, ashtu dhe “marrja në besë” për ta çuar kryetrimin në Orosh të Mirditës. Besa e shtatë luftëtarëve lajthizakë shkoi deri në përgjakjen për mikun, për fjalën e dhënë, për besën si institucion në historinë shqiptare. Të shtatë trimat luftëtarë të Lajthizës mbetën shembull trimërie e bese në panteonin e lirisë e pavarësisë së atdheut, që nuk kursyen as gjakun e tyre për mbrojtjen e kryetrimin Ded Gjon Luli si dhe duke shkruar një faqe lavdie për trevën dhe mbarë shqiptarinë. Sikurse “shtatë lajthizakët” Mirdita dhe jo vetëm ka dhjetra e qindra të rënë për truallin arbëror që njihen dhe trashëgoohen gojarisht historitë e trimëritë e

tyre, këndohen këngë dhe kanë hyrë në legjendat e trimërive shqiptare, por nevojitet shkrimi i historisë së tyre, pse jo edhe shpallja me titullin e lartë për të gjithë ata luftëtarë mirditorë dhe më gjerë që emrin e shkruan me trimëri në panteonin e burrave më të ndritur të kombit shqiptar. Tashmë që prej katër vjetësh ligji nr. 109/2018, “Për statusin e Dëshmorit të Atdheut”, e lejon plotësisht në aspektin juridik dhe kompetenca ligjore për fshatra, familje, shoqata organizma intelektuale e deri në pushtetin vendor që të rishikohen me themel të rënë e popullit shqiptar në të gjitha betejat e historisë në të 87 mijë kilometrat katrorë që kishin të katër vilajetet shqiptare. Statusi “Dëshmor i atdheut” është një rrugë plotësisht e hapur tashmë nga ana ligjore dhe që e mundësojnë dërgimin e dokumentacionit përmes Këshillit Bashkiak, Këshillit të Qarkut dhe Prefektit dokumentacion që përcillet komisionit Qendror të Statusit të Dëshmorit të Atdheut i ngritur pranë Ministrisë së Mbrojtjes.

Vëmëndja ndaj të rënëve është dhe mbetety detyrim brezash dhe mbi të gjitha detyrim institucionesh të shtetit. Djemtë luftëtarë të Mirditës janë një simbolikë nga më madhoret të historisë sonë, sikurse edhe strategu popullor i Malësisë në luftën për mbrojtjen e trojeve nga sulmet e fqinjëve veriorë, janë Dëshmorë të Atdheut, dhe e mbajnë këtë emër që prej Vendimit nr. 78 datë 23 Maj 1978.

Ata janë flamurbajtës të shqiptarisë, sikurse ishin flamurtarë malësorët e Ded Gjon Lulit, që flamurin e ngritën në majë të Bratilës në Deçiq të Alpeve më 6.4.1911. Shtatë lajthizakët do të nderohen dhe respektohen në të gjitha kohrat, për gjakun e derdhur, për nderin e Shqipërisë që e lartësuan edhe më shumë. Në këtë mënyrë dhe pesha historike e unitetit ndërkrainor Malësisë e Mirditës, e këtyre dy krahinave heroike të kombit shqiptar vlerësohet si duhet përmes gjakut të derdhur për idealin e lirisë dhe bashkimit kombëtar. Shënjtëria e të rënëve të kombit shqiptar nuk ka çmim, sepse i tillë është gjaku i derdhur për Atdhe. Nderim, respekt dhe mirënjohje dëshmorëve lajthizakë që ranë në një ditë me strategun e madh popullor Ded Gjon Luli.



PROFILI

Valixhja e Veteranit

Prof. Asoc. Dr. Bernard Zotaj

PËR HISTORINË E TIJ FLET VALIXHJA...

Këto ditë bëra një vizitë në shtëpinë e veteranit dhe partizanit të Br. I S, Zeno Shaskë Boci, i cili ka 13 vjet që është ndarë nga jeta. I kisha thënë të birit që dua të shkruaj diçka për veteranin e nderuar të Ramicës, më sill ndonjë të dhënë. Elmazi, i biri më tha ti shkoja në shtëpi, sepse më ka lënë një valixhe me materiale dhe dokumenta të tij. Aty janë, të presin që t'i shikosh. Mundësia e pruri dhe valixhja e veteranit u hap.

Zeno Boci ka lindur në vitin 1925 në një familje atdhetare të Ramicës. Prindrit e tij quheshin Shaskë Bocit dhe Hurma Idriz Bocaj. Familja e Shaskë Bocit ishte një familje me tradita patriotike dhe me të ardhura të bollshme. Shaska kishte kishte lindur rreth vitit 1890 dhe kishte qenë luftëtar në Luftën e Janinës 1913 dhe në Luftën e Vlorës 1920. Hurmaja kishte lindur rreth vitit 1900. Hurmaja, nuse e re përballoi punët e mëdha, duke i dhënë frontit të luftës duke gatuar dhe pjekur bukë, përgatitur bulmetra, djath, gjizë e gjalp, por edhe duke mbledhur prodhimet e stinës. Familja Shaska dha gjithçka që kishte për këtë luftë. Ajo jetoi plot një shekull. Lindi në fillim të shekullit e jetoi atë plotësisht dhe filloi edhe shekullin e XXI. Së bashku lindën dhe rritën 8 fëmijë, 6 djem dhe 2 vajzat dhe kanë gëzuar me 45 nipër dhe mbesa. Nënë Hurmaja nipërve dhe mbesave për ditë ju tregonte ndodhi e ngjarje nga më të ndryshmet, nga ato që ajo ka jetuar në këto 100 vjet.

Shtëpinë e Shaske në Gjoneç u kthye në një bazë të rëndësishme të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare. Hurma Idriz Bocaj kishte statusin e veteranes së LANÇ-it, si dhe kishte marrë medaljet e Trimërisë, të Kujtimit dhe të Çlirimit. Familja e saj u lidh ngushtësisht me LANÇ-in.

PARTIZAN NË BRIGADËN E PARË SULMUESE

Djali i madh Zenua u nis për në Br. I S. Partizani nga Ramica e Vlorës do

të niste marshimin luftarak legjendar për çlirimin e vendit dhe bashkë me partizanët e brigadës do të shkruanin epopenë më të lavdishme. Partizanët e kësaj brigade, edhe Zeno Boci do të luftonin dhëmbë për dhëmbë me armikun në çdo cep të Shqipërisë, në shi e dëborë, në tufan e zhegun përvëlues, ku ngrënë e ku pa ngrënë, ku veshur e ku pa veshur dhe nuk u mposht asnjëherë. Kjo brigadë zhvilloi më se 200 luftime e beteja kundër nazifashistëve dhe bashkëpunëtorëve të tyre ballisto-zogistë, të zhvilluara në të gjitha krahinat e vendit, të cilat do nisnin në Vithkuq, Mokër, Tenda e Qypit, Çermenikë e Martanesh, Dibër e Shkodër, Vlorë, Përmet e Sapat, Tiranë... Edhe jashtë kufijve të Atdheut u dëgjua pushka e brigadës që ngrinte peshë zemrat e popullit e tmerronte armiqtë dhe korri vetëm fitore. Me luftën e saj heroike Br. I S, njësia e parë e madhe e Ushtrisë Nacionalçlirimtare shqiptare, do t'i jepte tonin luftës e do të shndërrohej në yll polar për të gjitha brigadat e tjera partizane që u krijuan më pas në gjithë vendin, do të bëhej një shkollë e madhe e luftës partizane e artit ushtarak popullor, si dhe një fidanishte për prodhimin e kuadrove të talentuar e të guximshëm që ditën të drejtojnë formacione luftarake me aq shumë mënçuri e zotësi. Zeno Bocaj ishte bashkëluftëtar me Lesko Lekaj nga Ramica, vazhdimisht kujtonte se në luftën e Tendës së Qypit, Leskua ishte mitralier dhe mitralozin e tij kurrë se e lëshoi nga dora. Ndërsa në shkurt 1944, në Kajsë të Përmetit, Leskua u plagos rëndë. Ai shkoi për t'u mjekuar në spitalin partizan...

Në 79 vjetorin e formimit të brigadës dhe në kuadrin e 78 vjetorit të çlirimit, xha Zeno nuk ishte, por u kujtuan edhe një herë me respekt e dashuri të pakufishme për qëndresën heroike të partizanëve, heronjve dhe dëshmorëve, kuadrove drejtuese të cilët me patriotizëm, trimëri e aftësi udhëhoqën reparatet nga fitorja në fitore, kujtuam veprën e tyre madhështore dhe përkushtimin në shërbim të popullit e të atdheut, për gjithçka që ata bënë në emër të lirisë dhe të pavarësisë së vërtetë të Atdheut. Nga radhët e brigadës ranë 481 dëshmorë, edhe dëshmori nga Ramica Lesko Lekaj, si dhe 14 Heronj të Popul-



matik i librit, i shtypit dhe frekuentues i të gjitha veprimtarive që bëheshin në fshat. Fjala e tij dëgjohej me vëmendje dhe respekt të veçantë. Për rezultate në punë është vlerësuar me dekorata dhe stimuj të ndryshëm. Ai së bashku me Xhurxhinë, lindën dhe rritën, edukuan dhe mësuan djem dhe vjaza të mrekullshëm të cilët punojnë me përkushtim dhe me ndershmëri. Kur doli në pension ju përkushtua Organizatës së Veteranëve të LANÇ-it, ku dhe ka kontribuar e ka propoganduar idealet e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe partizane në brezin e ri.

lit të kësaj brigade që dhanë jetën për çlirimin e vendit nga bisha nazifashiste. Ata mbetën yje të pashuar e që ndriçojnë përherë në të gjitha kohërat, duke përcjellë mesazhe paqeje, lirie e demokracie dhe duke bërë thirrje që të hiqet dorë nga poshtërimet e dredhitë që bëhen për ta tradhtuar LANÇ-in duke u bërë njësh me nazifashistët e ballistët.

NË AKSIONET VULLNETARE

Pas çlirimit të vendit partizani Zeno Boci (Shaska) u kthye dhe punoi gjithë jetën e tij në Ramicë. Ai ka marrë pjesë në mjafta aksione si në hekurudhë, ndërtim rrugësh e urash... ka punuar në sektorin e bujqësisë me përgjegjësi dhe përkushtim.

Me fillimin e vitit 1945 me të rinjtë në çdo fshat u krijuan skuadrat e punës vullnetare, ku Zeno do të ishte ndër të parët. Gjatë vitit 1945, mbi 150 të rinj e të reja punuan për një farë kohe në Drashovicë, në Mavrovë e në Kropisht për grumbullimin e lëndës së ndërtimit lënë nga pushtuesit. Kështu filloi rindërtimi i të gjitha shtëpive të djegura dhe që përfundoi në vitin 1946, ku çdo fshat kishte komisionin e vet dhe kryetar i të gjithë komisioneve të fshatrave ishte Nazër Sulejman Bruhamaj. Në aksionet e ndryshme kombëtare, në vitet e para pas çlirimit morën pjesë mbi 120 të rinj e të reja. Këto aksione shërbyen dhe si shkolla edukimi. Në këto aksione Zeno Shaska do të ishte gjithmonë në krye.

Në vitin 1946 e në vazhdim Zeno Shaska me të tjerë shkuan në aksionin kombëtar për ndërtimin e rrugës Kukës-Peshkopi. Mbas këtij aksioni shumë të rinj dhe të reja, por dhe ish partizanë shkuan në aksionet e hekurudhës Durrës-Peqin, në hekurudhën Elbasan-Peqin. Më tej në vitet e mëvonshme me dhjetra smokthinjot punuan në aksionet për ndërtimin e hidrocentraleve mbi lumin Mat dhe të rrugëve hekurudhore.

Kudo në punë u shqua për cilësitë e mira që manifestonte, për respektin dhe fjalën e ngrohtë e bindëse me fshatarët, ndershmërinë dhe palodhshmërinë në punë, përkushtimin ndaj saj. Zenua ishte dhe një lexues i rregullt dhe siste-

TË JEMI TË KUJDESSHËM PËR RUAJTJEN E KËTYRE VLERAVE

Në valixhen e tij gjejmë të sistemuar të gjitha fotot që kishte bërë nga koha e luftës dhe deri në fund të jetës. Aty gjejmë të gjitha certifikatat, dëshmitë, dekoratat, nderimet që i janë bërë në vite, gazeta ku është shkruar për familjen, vërtetime dhe dokumenta të ndryshme, por që flisnin për Smokthinën, fshatin dhe njerëzit e afërt të tij, etj. Aty kishte dhe mjaft fotografi të miqve dhe të shokëve, ku të shënuara me emër dhe ku jo. Midis tyre kishin dhe libra të shkruara nga smokthinjot të ndryshëm, dhurata që i ishin bërë dhe dedikuar atij. Librat ishin të shkruara nga smokthinjot si të djathtë dhe të majtë, por që xha Zenua i kishte të gjitha në valixhen e tij.

Relike të tilla të lëna me kujdes nga dora e një partizani dhe veterani të luftës, janë një histori e gjallë që duhen ruajtur me fanatizëm dhe kujdes nga familjet e tyre. E them këtë pasi vite më parë, kur po shkruaja një libër për një pjesëmarrës në luftë dhe veteran të nderuar, kur ju drejtova familjes për të parë shënimet, materialet dhe dokumente që mund të kishte lënë, familjarët më thanë, se nga pakujdesia ato kishin përfunduar në koshin e plehërave të lagjes. Kështu humbi një pjesë e historisë së një veterani, por dhe kujtesa e një familje dhe më gjerë.

Në këtë drejtim, familjarë, mësuesit, historianët por dhe të gjithë së bashku duhet të jemi të kujdesshëm për ruajtjen e këtyre vlerave, në mos për shoqërin, ato kanë vlera për fshatin, lagjen, familjen. Kjo valixhe shumë mirë në momente të caktuara mund të ekspozohet në muzeun e fshatit, por edhe në familje kur janë kujtmet familjare por dhe për ditën e Veteranit etj.



PROMOVIMI

Fjala në promovimin e librit “Haki Taha në kufi të legjendës”, organizuar në Gjakovë më 10 shtator 2022

VEPRA HEROIKE E HAKI TAHËS – THIRRJE PËR BASHKIM KOMBËTAR




SHPENDI TOPOLLAJ

synimin për të cilin u shkrepën? Vetë autorët e kanë cituar thënien lakonike, por mjaft të mençur, se “Koburja u shkrep për t’u dëgjuar në shekuj”. Por çfarë e shtyu Hakiun drejt këtij sublimimi? Kujtoni jetën e tij prej nxënësi në shkollat tona, dhe atë të mësuesit të ndershëm e të përkushtuar vetëm në Shënnavlash, ku e mbajnë mend për njeri korrekt dhe të përkushtuar, që fliste me pasion e pjekuri për bashkimin e Kosovës me Shqipërinë. Shihni pastaj portretin e tij, ku shkëlqen një inteligjencë e një njeriu që di se ç’bën. Ndiqni dëshmitë e të gjithë atyre që kishin dijeni për rolin që ai mori përsipër në organizatën që krijuan.

Sillni ndërmend fjalët që shkëmbeu me Miladinin në zyrën e tij, gjakftohtësinë, vendosmërinë dhe trimërinë që tregoi në vrasjen e tij. Dhe pastaj, vetvrasjen, për të mos rënë në dorën e serbëve dhe atë flamurin kombëtar që mbante në gji, ku pati shkruar “Kosovës liri - bashkim

pas kësaj bindet se i duhet një armë. Dhe ajo armë nuk bëri ndonjë krim, por ndëshkoi në mes të Prishtinës, kriminelin e çështjes shqiptare, shok të kryekriminelit Dushan Mugosha. Ai e dinte mirë dhe e përjetësoi porosinë e Naim Frashërit i cili thosh: “Jetoni për Shqipërinë dhe vdisni për të”. Dhe mesazhet ai i kishte dhënë me kohë, qysh kur shkruante poezinë “Kosovë, o shpirti jonë!” ku shprehej: Shqiptarë ke, shqiptare je, / Shpirti nga trupi kurrë s’mund t’ndahet, / N’ty jetojmë, n’ty kem le, / Gjaku ujë kurrë s’mund të bahet!” Autorët e këtij libri monografik, me një stil të qartë e të thjeshtë, duke dashur të futen në vetëdijen e çdo lexuesi, me shumë të drejtë e kanë gjetur të udhës që paralelisht të na japin kohën andej e këtej kufirit, kur kjo ngjarje ka ndodhur.

Nënshtim deri në servilizëm ndaj serbëve, kërkesa Titos për ta bërë Shqipërinë e Gjergj Kastriotit që i tregoi vendin perandorisë më të



madhe të kohës, republikë të shtatë të Jugosllavisë, intriga në kurriz të Kosovës, vrasje masive të të ashtuquajturve nacionalistë që s’kërkonin tjetër veç bashkimin kombëtar, nën pretekstin absurd të bashkëpunimit me okupatorin, tortura, burgosje, internime, dyshime të pandara dhe shumë shpesh shkëmbime të atyre që reciprokisht kalonin kufirin, akuza se të gjithë kosovarët janë spiunë të UDB - së e të tjera poshtërsi që bënë ato regjime mizore, shoqërojnë veprën e Haki Tahës. Dhe këtu, askush nuk duhet të çuditet, pasi a nuk ishte Enver Hoxha, rajai i Miladinin, Dushanit, Tempos me shokë, ai që qysh gjatë luftës Nac - Çl, eliminoi pas shpine shokët e tij, si fjala vjen ata të fraksionit të Vlorës etj. që nuk donin paternalizmin jugosllav dhe propagandonin bashkimin e Kosovës? A nuk ishte po ai që për t’i bërë qejfin Titos, dëgjoi Miladinin, dhe denoncoi Marrëveshjen e Mukjes duke i çuar shqiptarët në luftë vëllavrasëse? Unë e di se në popullin e ndershëm të Kosovës, ende mund të ketë ndonjë keqkuptim për qëndrimet hipokrite të E. Hoxhës dhe partisë së tij ndaj çështjes së Kosovës. Dhe kjo e ka një shpjegim: të lodhur deri në raskapitje, nga përbuzja, keqtrajtimi, diskriminimi e ndëshkimi rankovician, njerëzit e Dardanisë krenare, e mendonin shpëtimin tek atdheu amë, pa ditur se ku e kishin katandisur atë.

Veç, është jashtë çdo dyshimi, se plumbat që u shkrehën mbi Miladinin, së pari i meritonte vetë Enveri. Edhe ia e ndiente këtë, prandaj vijonte ta quante atë komunist internationalist dhe Haki Tahën e dënoi me heshtje. Hakun e mori tek i vëllai dhe Qazim Vula, hetuesia, burgu dhe vuajtjet e të cilit, sikurse i ndeshim në libër, flasin shumë.

Dikush ka thënë se “Vepra historike mund të quhet e përfunduar jo

(Vijon në faqen 11)



me Shqipërinë”. Dhe mendoni se sa i poshtër ishte qëndrimi që PKSh - ja dhe Enver Hoxha, mbajtën ndaj veprës së tij. Për aktin e Haki Tahës u servirën disa variante zyrtare dhe të kulisave, sipas koniukturave politike që diktaturës i interesonte. Autorët, me besnikëri na e kanë dhënë gjithë rrjedhën e tyre, edhe kur midis varianteve mund të kishte mospërputhje. Por janë disa gjëra themelore që kanë një dhe vetëm një realitet. E tillë është edhe ajo mbledhja e Bashkisë këtu në Gjakovë, në frorin e vitit 1945, ku u zhvillua takimi me Miladinin dhe ku ai, duke ikur si i tërbuar pas pyetjeve që i bëri një qytetar, se përse nuk po bëhet bashkimi, iu përgjigj: Or, ti shok, a hala me ksi andrash po e rreni vetveten... a..?! Dhe këto fjalë plot paturpësi e cinizëm tingëljuan mjaft rëndë për idealistin Haki Taha që ishte i pranishëm, dhe që fill



Në gjithë historinë e Shqipërisë, janë disa krisma armësh që kanë lënë gjurmë lavdie në psikikën e popullit tonë, duke na bërë krenar, por sikur të donim t’i veçonim ato më emërmëdhate, do të përmendja ato të Avni Rustemit, Vasil Laçit, Adem Jasharit dhe patjetër ato e heroit tonë Haki Taha që vrau atë ditë marsi të vitit 1945, emisarin jugosllav antishqiptarin Miladin Popoviç. Prandaj sot është një ditë e shënuar, pasi përtej hartimit të një libri nga autorët e nderuar atdhetarë Bajram Halil Gashi e Halil Ahmeti, dhe akoma më tutje gjestit burror të protagonistit Haki Taha, ne po evokojmë vetë historinë e cila sikurse e ka saktësuar dikush, s’është tjetër veçse filozofia në shembuj. Dhe e gjithë kjo, pasi akti i Haki Tahës është vetëdija popullore, është brenga e madhe që na mundon të gjithë ne shqiptarëve, është revolta e ligjshme e Kombit, është lumi i gjakut që është derdhur dhe sakrificat e panumërta që brez pas brezi kemi bërë. Është tek e fundit, aspirata jonë e përbashkët ende e pa realizuar.

E meqenëse e nisa kështu ligjeratën time, lejomëni t’u kujtoj thënien lapidare të Viktor Hygoit që pyetjes se çfarë është historia, ju përgjigj: “Një jehonë e së kaluarës në të ardhmen, një pasqyrim i së ardhmes në të shkuarën.” E parë kështu, natyrshëm që edhe neve na lind me të drejtë pyetja: Libri që po promovojmë, ka pasur si qëllim të na shuajë kureshtjen dhe të zbardhë si në një roman policesk, veprimet trimërore të mësuesit - intelektual që sollën vrasjen e një jugosllavi me influencë në zhvillimet tona komuniste, dhe më pas vrasjen e vetë atij, apo efektin që patën në popull për zgjimin e ndërgjegjësimit e tij se ende ato krisma nuk kanë sjellë

SKICË LETRARE

Gjirokastritja e pamposhtur



Dhimitër SHTËMBARI

Më 17 shtator 2022, iu dha lamtumira e fundit invalides së shquar të LANÇ, Mesaret Karagiozi, ish bashkëshortja e pilotit legjendë Babaçe Faiku.

Nga libri im "Me gjuhën e plagëve", ku përfshihen jetëshkrimet e të gjitha shoqeve invalide të LANÇ, po jap vetëm një episod nga plagosja e së ndjerës Mesaret.

Lexim të këndshëm, miqtë e mi!

Gjirokastritja e pamposhtur

Si shumë të tjerë, Mesaret Karagiozi e nisi si e re antifashiste, e vazhdoi si luftëtare e Çetës Partizane "Koto Hoxhi", e vazhdoi si luftëtare e Batalionit Partizan "Thanas Ziko", për ta përfunduar si trime e Brigadës VIII Sulmuese Partizane.

... Në një luftim me nazistët gjermanë, diku në një grykë mali, rasti e kish dashur që Mesareti të ngrihej në këmbë. Dhe ashtu kishte vepruar. Me shpejtësi



pat hedhur një bombë në pozicionet naziste, por... krejt befas kish dëgjuar një zhurmë. Para syve - një vetëtimë rrufeje! Dhe kishte ndërjet fytyrën t'i përcëllohej nga një flakë.

Nga një flakë, që edhe ajo vet nuk e kish kuptuar

se nga i kishte ardhur! Një zhurmë e një flakë, që e kishte rrëzuar përtokë!

Atyre sekondave të para kish menduar se ishte djegur! Se ish verbuar krejtësisht! Se për të, ato sekonda do të kishin qenë çasti i fundit i jetës!

Instinktivisht kishte çuar dorën në fytyrë, por... oh! Nuk kishte mjekër! Nofulla i varej posht! I kishin mbetur vetëm dhëmbët e sipërme.

Ndërkohë, gjaku vazhdonte t'i vërshonte kraharorit dhe... përmes brinjve - gjithë trupit!

Dhe nisi të ndjente dhimbje. Atëherë kuptoi se ende ishte gjallë.

Ndërsa meditonte për jetën, e mbetur aty mes shkurreve, ishin shokët që i erdhën në ndihmë. Dhe ashtu, mes plumbave, e dërgojnë në familjen e një fshatari.

- Mos keni merak për këtë bukuroshe, - u kishte thënë e zonja e shtëpisë atyreve që e kishin sjellë aty.

Dhe, pa humbur kohë, kishte vazhduar t'i pas-tronte fytyrën me ujë të ngrohtë.

- A do t'i rregullohet goja?! A do t'i mbetet shenjë në fytyrë?! - i ishte drejtuar gjithë ankth një nga shoqet partizane zonjës së shtëpisë.

Eh, ç'ti thoshte e gjora zonjë e shtëpisë!

- Nuse e bukur do të bëhet. Ja, barnat po ia vemi...

Asaj pasditeje Mesareti u dërgua në spitalin partizan. Kohë më pas, ajo do të kalonte spitaleve në Shqipëri, por edhe jashtë vendit.

Dhe erdhi duke u përmirësuar.

Shokët dhe shoqet e invalides së LANÇ, Mesaret, teksa e takonin mbas operacioneve të shumta, ua kishte ënda t'i shqiptonin për humor vargjet që i kushtoheshin Kanan Mazes - Heroit të Luftës së Vlorës:

"Mesaret, t'u prish bukuria!"

Ndërsa ajo, me buzëqeshje, ua kthente:

"Të rrojë Shqipëria!"

(Marrë nga facebook - faqja personale e shkrimtarit dhe publicistit të mirënjohur Dhimitër Shtëmbari)

VEPRA HEROIKE E HAKI TAHËS,
THIRRJE PËR BASHKIM KOMBËTAR

(Vijon nga faqja 10)

atëherë kur u krye por vetëm pasi ajo të jetë bërë pronë e pasardhësve". Ne, falë luftës lavdiplote të UÇK - së dhe asaj të NATO - s me SHBA në krye, të cilës do t'i jemi përjetësisht mirënjohës, po jetojmë lumturisht një tjetër realitet. Por a e kemi shpënë deri në fund amanetin e dëshmorëve tanë? Mendoj se kemi ende shumë për të bërë, pasi është gjëja më absurde që Shqipëria të mbetet ende e ndarë.

Politikanët tanë të angazhuar me sherret mes tyre në luftën për pushtet, ose kanë harruar të ngrënë zërin deri në kupë të qiellit, për paradoksin e ndarjes dhe domosdoshmërinë e bashkimit ose janë frikacakë dhe jo pasardhës të atyre trimave që duke mbetur ndër rapsodi, janë shndërruar në legjenda. Uroj që kurrë të mos më dalë fjala, por e kam shprehur publikisht ndër librat e mij dhe në artikujt e botuar, se po lodhen kot duke përkëdhelur politikën agresive serbe, duke ju lutur atyre ta njohin shtetin e Kosovës, se gjoja ata do të bëhen tani e tutje miq me ne.

Po pse, dinjiteti, liria e pavarësia e Kosovës tonë të shtrenjtë ka mbetur në dorën e Gebelsit Aleksandar Vuçiç? Si mund të shkohet në bisedime me atë që thotë ndërkombëtarisht se nuk e njohim dhe nuk do ta njohim ndonjëherë shtetin e Kosovës? A nuk të kujton kjo historinë e gjeneralit Konde që pasi hyri në qytetin e pushtuar, ku nuk ranë këmbanat, dhe pyeti për këtë Prefektin, ky iu përgjigj se ka 19 arsye, ku e para ishte se nuk kishte këmbana.

Por fundja, Kosovës ju prish gjiza po nuk e

njohu Serbia. Askujt nuk i ka ardhur e keqja nga shqiptarët. Ata që e kanë pësuar, jemi ne, që na coptuan sikur të ishim kulaçi i gjysheve të tyre. Por të mos harrojmë, se zgjidhja përfundimtare e problemit tonë kombëtar, ka nevojë sidomos edhe për fjalën e zgjuar, argumentuese e kurajoze të intelektualëve, historianëve, shkrimtarëve dhe poetëve që sidomos Kosovës nuk i kanë munguar asnjëherë. Mund ta kem gabim, se fundja përmendja e emrave nuk më nderon dhe as e kam të drejtën t'i bëj gjyqin ndokujt, por gjersa ata shpallen vetë, mendoj se ide të tilla si ajo e Lulzim Pecit, Agron Demjajas, Halil Matoshit, Nexhmedin Spahiut e ndonjë tjetri, se Shqipëria dhe Kosova janë dy kombe të ndryshme, është as më shumë e as më pak, por zgjatim i teorive të Vasa Cubriloviçit dhe gjithë antishqiptarëve të tjerë, deri te rrufjani Kapllan Resulbegoviç.

Të tilla shpikje i bëjnë një dëm e karshillëk të madh aspiratës shekullore të popullit tonë, të shkruar me gjak dëshmorësh e martirësh. Mendoni si do të ndiheshin dhe sa do të zhgënjeshin, sikur të ngriheshin nga varret ata që dhanë jetën për këtë bashkimin.

Pikërisht kjo ja shton edhe më shumë vlerat librit të Bajram Gashit e Halil Ahmetit për një hero të pavdekshëm që na mblodhi sot. Ky libër i shkruar me kaq dashuri sikur na thotë se është koha më shumë se asnjëherë tjetër të kujtojmë thirrjen e Hasan bej Prishtinës që ja kushtoi jetën këtij bashkimi, se "Mëmëdheu qan për trima e burra, por jo për qyqarë e tradhtarë".

MESARETE IMERAJ -
Lilo Labja, që frymëzoi skenaristët për filmin shqiptar
"Malet me blerim mbuluar"

Më 17 shtator 2022 ndërroi jetë në moshën 95-vjeçare, Mesarete Imeraj (Karagiozi) që njihet nga shqiptarët si Lilo Labja.

Lilo Labja, personazhi që plagoset në filmin shqiptar 'Malet me blerim mbuluar' nuk është një fantazi e skenaristit, por është bazuar tek historia reale e një partizaneje që ka qenë pikërisht Mesarete Imeraj. Por në fakt rolin e Lilo Labes e ka luajtur Yllka Mujo.

Veterania e Luftës Antifashiste Nacional-Çlirimtare ishte padyshim monument i gjallë i partizanës trime që vuri lirinë e atdheut mbi gjithçka.

SPECIALE

SHPENDI TOPOLLAJ, KRYETARI I RI I DEGËS SË OBVL DURRËS



(Vijon nga faqja 3)

likës, LSHA të Rusisë ku i janë botuar pesë romane, e ka shpallur fitues të çmimit "Pushkin" etj. Vetëm gjatë periudhës së pandemisë, ai ka botuar 15 libra të rëndësishëm si "Esse rreth shprehjeve mitologjike", "Dantja e të tjerë", "Shenjtorët e librave", "Flas për ju", "Çlirova shpirtin", "Flisni miq", "Përsiatje rreth pikurës", "Pajtimi", "Romancë me letra dashurie", "E përdala", "Ata ishin njerëz", "E pabesueshmja", "Kur qesh e qan Kadareja", "Klithma nga burgu" dhe ky i tanishmi "Zë në shkretëtirë" me kritika letrare i cili u botua si dhuratë për ditëlindjen e tij nga Shtëpia Botuese 2MPrinting.

Në 70 librat e tij, Sh.Topollaj prezantohet si mjeshtër i profilit, duke krijuar personazhe si shembëlltura që të mbeten në kujtesë. Tërë krijimtaria e

tij është në një linjë vetëpërbushëse, ku autori me mjeshtëri di të përveçojë protagonistë të veshur me detaje që vetëm syri i mprehtë dhe mendja pjellore i shpërfaq aq mjeshtërisht. Në librat e tij depërton thellë në shpirt, në strukturën e personazheve si njerëz të matur që veprojnë në kontekst duke marrë prej tij, maksimalisht suksesin. Ashtu siç është edhe vetë në jetë autori Shpendi Topollaj, personazhet realë që përshkruan në librat dhe esetë e tij janë karaktere që bartin dashuri dhe buonsens, veti të qenësishme inteligjence.

Në fushën e të shkruarit dhe në disa institucione ku ka punuar evidentohet këmbëngulja dhe vullneti i tij për të studiuar, për të mbledhur burimet parësore, për të mësuar nga përvoja e tjerëve që është pjesë e stilit të punës kërkimore të Tij.

A do dal politika serbe nga rrethi i mbyllur për zgjidhjen e problemeve me Kosovën ?



Nga Bashkim Hisari

(vijon nga fq. 1)

Sigurisht, duke qenë se anëtarësimi i Serbisë në BE është ende larg, në këtë fazë, Serbisë nuk do t'i kërkohet njohja formale ligjore e Kosovës", thuhet në tekst, ku përmendet edhe përdorimi i termit "pranimi i Kosovës" në vend të "njohjes".

Nëse pranohet propozimi për marrëveshjen e re, Kosovën do ta pranojnë edhe pesë shtetet të BE-së që akoma nuk e kanë njohur dhe gradualisht Kosova do të anëtarsohet në organizatat ndërkombëtare, si në Këshillin e Evropës, INTERPOL, UNESCO dhe do fillonin negociatat për antarësim në NATO dhe BE. Antarësimi në KB do të shtyhej deri në një njohim të dytë për shkak të raporteve aktuale të shteteve Perendimore me Rusinë e cila ka të drejtën e vetos në Këshillin e Sigurimit të KB. Ndërkaq, Serbia do të përfitojë lehtësime për antarësim në BE dhe ndihma të rëndësishme financiare. Propozimi në fund parasheh edhe si të vazhdohet më tutje nëse Kosova dhe Serbia nuk pranojnë këtë propozim.

"Korniza e Re" e dialogut mes Kosovës dhe Serbisë u demantua nga Gjermania. Në Kosovë, dhe Serbi qarkullojnë opinione të kundërta për këtë dokument. Kryeministri i Kosovës Albin Kurti, duke folur për këtë kornizë deklaroi: "Ne nuk lejojmë që të problematizohet Kosova, por duam zgjidhje

"KORNIZA E RE" E DIALOGUT MES KOSOVËS DHE SERBISË

për marrëdhëniet problematike midis Kosovës dhe Serbisë. Unë e pranoj se marrëdhëniet ndërmjet Kosovës dhe Serbisë nuk janë normale, por Kosova është shtet normal, dhe këto marrëdhënie anormale midis Serbisë dhe Kosovës duhet të ndryshohen". Rreth kësaj kornize ishte pyetur edhe presidentja Vjosa Osmani. "Idetë që nuk kontribuojnë drejtë njohjes reciproke asnjëherë nuk mund të kontribuojnë për paqën dhe stabilizimin", - ka thënë ajo.

Presidenti serb Aleksandar Vuçiq, duke folur nga Nju Jorku për mediat në Serbi, pranoi se të dërguarit e Francës dhe Gjermanisë, të shoqëruar nga i dërguari i posaçëm i BE-së për dialogun, Miroslav Lajçak, i dhanë atij një "dokument me katër faqe, që atij i ka shkaktuar kokëdhimbje" për ç'arsye ka refuzuar ta marrë atë. Vuçiq nuk tregon gatishmëri për bashkëpunim për të zgjidhur problemin shumëvjeçar me Kosovës.

Përkundërazi, në të njëjtën kohë kur presidenti rus Vladimir Putin shpall mobilizimin e pjesës së rezervistëve ushtarakë dhe deklaroi se "Rusia ka armatim më të mirë se NATO dhe se janë të gatshëm ta përdorin", presidenti serb Vuçiq dërgon mesazhe nxitëse dhe kërcënuese për të penguar perspektivën e Kosovës duke paralarmuar se do të merren masa të fuqishme kundër Kosovës. Ditë më parë ai në Nju York deklaroi se: "bota po i afrohet një konflikti të madh, i cili nuk është parë që nga Lufta e Dytë Botërore, dhe në të cilin vendet e vogla nuk mund të presin ndonjë lajm të mirë". Deklarata të tilla mund të thellojnë edhe më shumë problemet midis Kosovës dhe Serbisë.

Edhe subjektet tjera politike në Serbi nuk po tregojnë interesim për zgjidhjen e problemeve me të Kosovës me negociata që do të përfundojë me marrëveshje ligjrisht të detyrueshme që përfshin njohjen reciproke mes palëve; insistojnë në "zgjidhje kompromisi",



por nuk tregojnë se çfarë do të thotë kompromisi.

Ditë më parë, Parlamenti i Serbisë miratoi raportin për dialogun me Kosovën. Raporti liston aktivitetet në kuadër të përgatitjes për realizimin e negociatave, përfshirë: asociacionin e komunave me shumicë serbe, policinë, gjyqësorin, energjinë, dhomat ekonomike, transportin e mallrave të rrezikshëm, si dhe të zhdukurit, që gjenden në kapitullin e fundit.

Në rrëmujën e pakuptimtë të debatit, të marrëzive primitive, të ngjyrosura me shovinizëm dhe nacionalizëm të skajshëm, me poltronizëm ndaj despotit të tyre dhe me ofendime ndaj shqiptarëve, nuk u dëgjua asgjë me maturi dhe arsye, përpos mohimit kolektiv të realitetit lidhur me zgjidhjen e problemeve në Kosovë në dy dekadat e fundit. Munguan përgjigjet për çështje që kanë të bëjnë me moralin, përgjegjësinë, drejtësinë...

Gjatë më shumë se 20 orë debati në seancën parlamentare nuk u dëgjua asnjë fjalë për varrojsen e kufomave e më shumë se dy mijë civilëve shqiptarë në varreza massive në Serbi e as për varrezat e Batajnicës, ku u gjetën fletore shkollore dhe çanta të fëmijëve të vrarë shqiptarë që ndodhen vetëm disa kilometra larg godinës së parlamentit, ku debatohej për Kosovën. Në foltoren e Parlamentit

serb deputetët në vazhdimësi injorojnë faktin se plani i shtetit të Serbisë ishte shkatërrimi dhe persekutimi i popullatës shqiptare, në kuadër të së cilës u vranë rreth 16 mijë njerëz dhe se ky plan u zbatua nga regjimi, ministri dhe zëdhënësit e atëhershëm, disa prej të cilëve tani janë në pushtet dhe sundojnë në Serbi. Për ta, mosnjohja e shtetësisë së Kosovës, përpjekjet për të penguar pranimin e Kosovës në Kombet e Bashkuara dhe në organizata tjera ndërkombëtare, dhe mohimi i të drejtave të shqiptarëve, janë çështjet dominuese në politikën e tyre që nuk rezultojnë zgjidhje, Presidenti serb, Aleksander Vuçiq në seancën e Parlamentit tha se "nuk do ta njohë pavarësinë e Kosovës". Këtë e përsëriti edhe në promovimin e oficerëve të Forcave të Armatosura Serbe në Beograd, me ç'rast tha se ata që kërcënojnë Serbinë "kurrë nuk e kuptuan vendosmërinë tonë për të mbrojtur atë që është e jona" duke shtuar: "nuk do t'ia japim askujt Kosovën dhe Metohinë dhe as një pëllëmbë të atdheut tonë".

Heshtja për realitetin juridik dhe politik të Kosovës është kontribut i rrezikshëm për Serbinë, e privuar nga turpi dhe ndjenjat e përgjegjësisë për gjithë atë që ka bërë dhe po bënë kundër shqiptarëve. Mbetet të presim dhe të shohim se a do të dalë politika serbe nga ky rreth i mbyllur?

Gazeta "VETERANI": website: <http://WWW.VETERANIOBVL.ORG/>;

Facebook: Veteran; Email: veterani.obvl@yahoo.com & halilrama@yahoo.com;

Nr.Cel: 0674070402; Adresa: Në Ministrinë e Mbrojtjes, Tiranë